





MITROVICA
KOMPAKNA UJESJELJESI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPAKNA REGIONALNI VODOVOD D.O.


Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë

DATA: 02.02.2026 NR.: 01-33812

Rishikimi i Planit të Biznesit 2026-2028 i KRUM-së

Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e rregullt nr. 01-2026 të mbajtur më datë 02.02.2026 pas shqyrtimit të Rishikimit të Planit të Biznesit 2026-2028 aprovoi Rishikimin e Planit të Biznesit. Plani i aprovuar do t'i dërgohet NJPMNP-së.

	<i>Delegoi</i>	<i>Aprovoi</i>
<i>Emri Mbiemri</i>	Kryeshafi Ekzekutiv Bashkim Kurti	Kryesuesi e BtD-së: Kumrije Kelmendi Aliu
<i>Nënshkrimi</i>		
<i>Data</i>	02.02.2026	02.02.2026



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI “MITROVICA” Sh. A.

RISHIKIMI I PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2026

PARASHIKIMI PËR VITET 2027-2028

Mitrovicë, JANAR 2026

PËRMBAJTJA

.....	2
Lista e figurave	5
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
2. PREZANTIMI I ORGANIZATËS	7
3. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	8
3.1. Analiza organizative	8
3.2. Analiza teknike dhe operative.....	11
3.3. Analiza financiare.....	17
3.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)	18
4. VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	20
4.1. Vizioni.....	20
4.2. Misioni	20
4.3. Vlerat Themelore	20
4.4. Objektivat Strategjikë	20
5. STRATEGJITË KRYESORE ZHVILLIMORE	21
5.1. Strategjia Financiare	21
5.2. Strategjia Teknike dhe Operative.....	21
5.3. Strategjia për Konsumatorët.....	22
5.4. Strategjia për Burimet Njerëzore	22
5.5. Strategjia për Inovacion dhe Digjitalizim	23
5.6 Strategjia e integritit të komunave veriore	24
6. PLANI OPERACIONAL / ZHVILLIMOR (Përmbledhje)	25
7. PLANI FINANCIAR.....	28
7.1. Të ardhurat dhe shpenzimet operative	29
7.2. Analiza financiare e shitjes.....	33
7.3. Burimet e financimit	35
8. PLANI I INVESTIMEVE.....	36
8.1. Projektet kryesore kapitale	36
8.2. Analiza e fizibilitetit dhe ndikimit.....	45
8.3. Afatet dhe prioritetet kohore	45

9. RREZIQET DHE MENAXHIMI I TYRE	47
10. PJESA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE	49
11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	50
11.1. Mekanizmat e monitorimit	50
11.2. Indikatorët e performancës	50
12. MJEDISI, KOMUNITETI DHE TRANSPARENCA	51
SHTOJCË	52

Lista e tabelave

Tabela 1. Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2025	10
Tabela 2. Grupmosha e të punësuarve.....	10
Tabela 3. Impiantet për trajtimin e ujit (ITU).....	11
Tabela 4. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit	13
Tabela 5. Kapacitetet prodhuese sipas ITU-ve.....	16
Tabela 6. Buxheti sipas departamenteve	26
Tabela 7. Tarifat	29
Tabela 8. Pasqyra e të ardhurave	30
Tabela 9. Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2026-2028.....	31
Tabela 10. Caqet kryesore të performancës.....	32
Tabela 11. Plani i faturimit të ujit në m3	34
Tabela 12. Plani i faturimit në euro	34
Tabela 13. Plani i inkasimit në euro	35
Tabela 14. Investimet vetanake.....	36
Tabela 15. Projektet e planifikuara.....	38
Tabela 16. Burimet ujore	52

Lista e figurave

Figura 1. Struktura Organizative	8
Figura 2. <i>Harta . Impiantet e trajtimit të ujit të pijes</i>	12
Figura 3. Rrjeti primar dhe sekondar I ujit pa pjesen Veriore.....	14
Figura 4. Burimet ujore.....	52

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani trevjeçar i biznesit të KRU “Mitrovica” Sh.A. për periudhën 2026–2028 paraqet një dokument strategjik dhe operacional, i cili synon forcimin e qëndrueshmërisë financiare, përmirësimin e efikasitetit teknik dhe zgjerimin e shërbimeve në të gjithë zonen e mbulimit, përfshirë edhe njësitë veriore të sapo integruara. Ky plan përfaqëson një udhërrëfyes të qartë për mënyrën se si ndërmarrja do të arrijë objektivat e saj zhvillimore, duke siguruar një qasje të balancuar midis stabilitetit financiar dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike.

Në aspektin financiar, plani parasheh një rritje të ndjeshme të të hyrave si rezultat i aplikimit të tarifave të reja të aprovuara nga ARRUE dhe zgjerimit të bazës së konsumatorëve në mbi 77,000. Arkëtimet pritet të rriten në mbi 17 milionë euro deri në vitin 2028, ndërsa mbulimi operacional do të mbetet mbi 120%, duke garantuar vetëqëndrueshmëri afatgjatë. Një fokus i veçantë i është kushtuar reduktimit të ujit të pa faturuar nën 45%, përmes investimeve në rrjet, zonave DMA dhe **uje** matësve inteligjentë.

Në planin teknik dhe investiv, ndërmarrja do të zbatojë projekte madhore si Impianti i Trajtimin të Ujërave të Zeza Mitrovicë–Vushtrri me financim të BERZH dhe BEI, rehabilitimi i rrjeteve kryesore, instalimi i SCADA-s dhe investimet energjetike fotovoltaike për reduktimin e kostove të energjisë. Po ashtu, parashihet modernizimi i flotës operative, IT-së dhe përmirësimi i laboratorëve të cilësisë.

Në aspektin organizativ, plani thekson përmirësimin e menaxhimit financiar, eliminimin e gjetjeve të auditorit, avancimin e sistemeve të raportimit sipas IAS/IFRS, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes trajnimeve dhe ngritjes profesionale. Këto masa do të kontribuojnë në forcimin e kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efikasitetit të stafit.

Në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe mjedisore, ndërmarrja do të thellojë bashkëpunimin me komunitetin dhe institucionet lokale përmes marketingut publik dhe transparencës, duke organizuar aktivitete sensibilizuese si “Dita Botërore e Ujit” dhe realizimin e dokumentarëve promovues për ndërgjegjësimin qytetar mbi përdorimin e qëndrueshëm të ujit.

Në përfundim, plani 2026–2028 synon të vendosë KRU “Mitrovica” si model të ndërmarrjeve publike të qëndrueshme dhe inovative, që operon me standarde të larta profesionale, transparencë të plotë dhe përkushtim ndaj cilësisë, mjedisit dhe komunitetit që e shërben.

2. PREZANTIMI I ORGANIZATËS

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” Sh.A. është një ndërmarrje publike rajonale me aksionar Qeverinë e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë, e themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe me kornizën ligjore që rregullon sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Kompania ka për mision të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë të pijshëm dhe menaxhim efikas të ujërave të ndotura, në përputhje me standardet mjedisore dhe sanitare të Bashkimit Evropian.

Ujësjellësi i Mitrovicës ka një histori që daton nga vitet 1940, kur filloi furnizimi i parë me ujë për qytetin e Mitrovicës. Sot, KRU “Mitrovica” operon me tri Impiante të Trajtimit të Ujit (Shipol, Balincë dhe Zubin Potok) dhe një Impiant të Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Llaushë, duke menaxhuar një rrjet të gjerë prej mbi 1,600 kilometrash ujësjellës dhe rreth 280 kilometrash kanalizim. Kompania furnizon me ujë të pijshëm dhe trajton ujërat e ndotura për mbi 190,000 banorë, me rreth 70,000 konsumatorë të regjistruar në territorin e shtatë komunave: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut.

Në maj 2025, ndërmarrja ka zgjeruar zyrtarisht veprimtarinë e saj në komunat veriore të Kosovës, duke integruar në menaxhim Mitrovicën e Veriut, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Leposaviqin. Si rezultat, kompania tani operon përmes gjashtë njësive operative: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut – Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq. Ky zgjerim shënon një hap të rëndësishëm drejt integritetit të shërbimeve publike në gjithë rajonin dhe rritjes së ndikimit institucional të kompanisë. KRU “Mitrovica” ka rreth 260 punonjës, me plotësimin e pozitave për Veri gjithsej bëhen 380 punonjës, të organizuar sipas një strukture të qartë funksionale dhe operon në përputhje me rregulloret e ARRU-së për tarifat, standardet e cilësisë dhe raportimin financiar.

Në kuadër të zhvillimeve të fundit institucionale, KRU “Mitrovica” Sh.A. ka zgjeruar licencën e saj operuese nga Autoriteti Rregullativ i Ujësjellësve (ARRU), duke përfshirë në zonën e saj të operimit edhe komunat Zubin Potok dhe Leposaviq. Ky zgjerim shënon një hap të rëndësishëm drejt unifikimit të plotë të shërbimeve në nivel rajonal. Njëkohësisht, kompania ka ndryshuar modelin e faturimit për Mitrovicën Veriore dhe Zveçanin, duke kaluar nga faturimi me shumicë në faturim me pakicë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e ARRU-së. Kjo nënkupton që konsumatorët në këto zona tani do të faturohen mbi bazën e konsumit të tyre real individual, ashtu si të gjithë konsumatorët tjerë të rrjetit.

Kompania është partnere e rëndësishme në projekte zhvillimore me KFW, BERZH dhe Bashkimin Evropian, të cilat mbështesin investimet kapitale për rehabilitimin e rrjetit, ndërtimin e impianteve të reja dhe digjitalizimin e proceseve. Falë këtij zhvillimi institucional dhe teknologjik, KRU “Mitrovica” është pozicionuar si një ndërmarrje publike moderne dhe e qëndrueshme, që udhëheq me transparencë, efikasitet dhe përkushtim ndaj qytetarëve të rajonit.

3. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

3.1. Analiza organizative

KRU "Mitrovica" Sh.A. udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e Lartë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Sekretari i Korporatës/ Këshilltari i Përgjithshëm. Ekipi menaxhues i kompanisë përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i mbështetur nga ekipi i tij i udhëheqjes, gjegjësisht nga Drejtorët e Departamenteve. Janë katër (4) Departamente Organizative në kuadër të Kompanisë si më poshtë:

1. Departamenti Administrativ
2. Departamenti Financiar
3. Departamenti Komercial dhe
4. Departamenti Teknik

KRU "Mitrovica" Sh.A. është një kompani publike nën administrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila njëkohësisht është edhe aksionare e Ndërmarrjes.




Figura 1. Struktura Organizative

Skema organizative e paraqitur në këtë kapitull ndjek modelin e piramidës, duke e strukturuar bartjen e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve në mënyrë hierarkike: nga niveli më i lartë

drejt atij më të ulët, ndërsa kryerja dhe raportimi i detyrave realizohet në drejtim të kundërt, pra nga poshtë-lart.

Skema aktuale organizative është miratuar nga Bordi i Drejtorëve i KRU “Mitrovica” më 27.12.2022, ndërsa me rishikimin e Planit të Biznesit, kjo skemë është rishikuar dhe miratuar përsëri nga Bordi më 29.07.2025.

Me zgjerimin e shtrirjes operative në Mitrovicën Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, kompania synon të shtojë numrin e punëtorëve nga 260 në 406 deri në vitin 2028, me qëllim ruajtjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve.

KRU “Mitrovica” Sh.A. ka përfshirë në skemën e re organizative njësitë operative të Mitrovicës Veriore & Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Këto njësi janë tashmë të aprovuara zyrtarisht në strukturën organizative të kompanisë, duke u bërë pjesë integrale e sistemit të saj operativ. Për secilën njësi është paraparë strukturë e dedikuar menaxheriale, teknike dhe administrative, me qëllim sigurimin e funksionimit të pavarur dhe efikas, në përputhje me standardet e kompanisë dhe kërkesat e rregullatorit.

Çdo njësi do të ketë staf të plotë për operim teknik, mirëmbajtje, lexim, arkëtim dhe administratë, me strukturë të standardizuar për të gjitha njësitë.

Njësia Operative: Mitrovicë Veriore dhe Zveçan

Kjo njësi do të funksionojë si një njësi e përbashkët për të dy komunat, duke u bazuar në afërsinë gjeografike dhe lidhjen infrastrukturore të rrjetit të ujit. Ajo do të drejtohet nga një Menaxher i njësisë, i cili do të ketë nën menaxhim tre shefa sektorësh: për mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit, për leximin dhe faturimin si dhe shefin e kontrolles. Struktura përfshin gjithashtu staf teknik dhe terreni, si ujëinstalues, kanalizatorë, bageristë, shoferë dhe punëtorë fizikë, të cilët do të jenë përgjegjës për reagime të menjëhershme dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Për segmentin administrativ, janë të angazhuar arkatarë dhe lexues të ujëmatësve, që mbulojnë të dy komunat, si dhe staf mbështetës për pastrim dhe siguri (roje). Inxhinierët e hidros dhe teknikët e elektromakinerisë do të sigurojnë operim të qëndrueshëm të pajisjeve dhe stacioneve teknike.

Njësia Operative: Zubin Potok

Njësia e Zubin Potokut do të menaxhohet nga një Menaxher i njësisë, i cili do të mbështetet nga dy shefa sektorialë (mirëmbajtje dhe faturim). Struktura e stafit garanton mbulim të plotë të terrenit dhe reagim të shpejtë për mirëmbajtje dhe ndërhyrje teknike. Njësia do të ketë gjithashtu staf për administrim dhe siguri (arkatarë, roje, pastruese) me qëllim funksionimin e pavarur të qendrës operacionale.

Njësia Operative: Leposaviq

Njësia e Leposaviqit është projektuar me të njëjtën strukturë funksionale si ajo e Zubin Potokut, duke siguruar balancë ndërmjet sektorit teknik dhe administrativ. Menaxheri i njësive do të koordinojë aktivitetet e mirëmbajtjes dhe faturimit në nivel ditor, ndërsa stafet teknike (ujëinstalues, kanalizatorë, bageristë, shoferë dhe punëtorë fizikë) do të mbulojnë rrjetin në zonat përreth. Për shkak të ndërtimit të pritshëm të fabrikës së ujit në Leposaviq, struktura është konceptuar që të përfshijë edhe laborantë, dozatorë dhe dispeçerë, të cilët do të jenë përgjegjës për menaxhimin e procesit të trajtimit të ujit dhe mbikëqyrjen e parametrave të cilësisë. Arkatarët dhe lexuesit do të kryejnë faturimin dhe arkëtimet lokale, duke mundur qasje të drejtpërdrejtë për konsumatorët.

Në tërësi, për këto njësi janë aprovuar gjithsej 121 pozita për periudhën e parë të operimit, të shpërndara proporcionalisht sipas nevojave operative të secilës komunë. Menaxhimi i këtyre njësive do të realizohet në mënyrë të decentralizuar, por nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zyrës qendrore, për të siguruar koordinim strategjik, standarde unike operimi dhe raportim të integruar financiar e teknik.

ITU Zubin Potok

Kjo ITU ka karakteristikë të veçantë për shkak të rëndësisë së fabrikës së ujit në funksion të furnizimit të tri komunave veriore me ujë si ndihmësë e impiantit në Shipol. Kjo e bën të domosdoshme përfshirjen e laborantëve për analizat e ujit dhe dozatorëve për menaxhimin e kimikateve, si dhe të dispeçerëve për koordinimin e operimeve ditore.

Për vitin 2026-2028 në bazë të kërkesave nga Departamentet e kompanisë parashikohet rekrutimi për pozita prioritare në nivele teknike dhe menaxheriale.

Tabela 1. Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2025

Gjinia	NUMRI I PUNONJËSVE	PËRQINDJA%
Gra	32	12.50 %
Burra	224	87.50 %
Total	256	100.00%

Sa i përket strukturës demografike, mosha mesatare e punonjësve është 48.5 vjeç.

Tabela 2. Grupmosha e të punësuarve

	Vitet (nga- deri)								
Grup mosha	21-25	26-30	31- 35	36-40	41-45	46-50	51-55	56-60	61-65
Numri i personelit	2	19	26	20	29	40	42	44	34
Mosha mesatare deri me datë 30.09.2025 është rreth 48.50 vjeç									

3.2. Analiza teknike dhe operative

KRU “Mitrovica” menaxhon një sistem të integruar furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimi, i cili përfshin tre fabrika funksionale të trajtimit të ujit dhe një impiant trajtimi të ujërave të ndotura, me infrastrukturë të shpërndarë në tri komuna dhe zona të zgjeruara Veriore.

Impiantet e trajtimit të ujit:

Tabela 3. Impiantet për trajtimin e ujit (ITU)

Nr	Emri i ITU	Komuna	Viti i ndërtimit /funktionalizimit	Kapaciteti (l/s)	Statusi
1	ITU Shipol	Mitrovicë	2014	700 l/s	Aktiv – furnizon Mitrovicën, Mitrovicën Veriore, Zveqanin dhe Skenderajn
2	ITU Balinc	Vushtrri	2016	300 l/s	Aktiv – furnizon qytetin dhe fshatrat e Vushtrrisë
3	ITU Zubin Potok	Zubin Potok	-	150 l/s	Aktiv – furnizon Zubin Potokun, një pjesë të Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore
4	Trajtimi i ujit	Leposaviq	-	30 l/s	Impianti aktual i papërfunduar, përderisa trajtohet uji edhe në dy pika tjera.




Figura 2. Harta . Impiantet e trajtimit të ujit të pijes

Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura

KRU “Mitrovica” operon me Impiantin e Trajtim të Ujërave të Ndotura në Llaushë (ITU-Llaushë) i cili mbulon një pjesë të zonës së Skenderajt deri në Tetor janë trajtuar 488,504 m³. Në këtë laborator bëhen analizat fiziko-kimike të ujërave të ndotura, dhe si i trajtuar i plotëson kushtet për tu shkarkuar në lum.

Ndërsa është në fazë zbatimi projekti madhor Impianti Rajonal Mitrovicë–Vushtri, me vlerë investimi 39.3 milion € i financuar nga EBRD, EIB, EBIF dhe Qeveria e Kosovës.

Ky impiant do të mundësojë trajtim biologjik të ujërave të ndotura për zonat e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, duke ulur ndjeshëm ndikimin në mjedis.

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

Rrjeti përfshin linja primare, sekondare dhe degëzuese, me materiale të tipit AC, PE dhe PVC.

Sistemet mbështetëse:

- SCADA: në funksion në ITU Shipol, Balinc, ITU Zubin Potok me plan zgjerimi edhe në Leposaviq.

- GIS: funksional për 85.5% të rrjetit total të ujësjellësit në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, ndërsa komunat veriore janë në proces.
- Laboratori Qendror në Shipol: kryen analiza fiziko-kimike dhe duke filuar nga viti 2026 edhe bakteriologjike për kontroll të cilësisë së ujit, tani veq në proces akreditimi sipas ISO 17025.

Vlerësim i gjendjes teknike:

Rrjeti dhe impiantet janë funksionale, por kërkojnë investime në:

- rehabilitim të gypave AC dhe zonave me humbje të larta,
- modernizim të SCADA-s dhe ndërlidhje ndër-impiantore,
- efikasitet energjetik në pompime,
- ndërtim të rrjetit sekondar të kanalizimit në zonat rurale.

Tabela 4. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit

Njësia	Gjatësia e rrjetit të Ujësjellësit
Mitrovicë	523.24 km
Vushtrri	725.55 km
Skenderaj	417.00 km
Totali	1,665.48 km
Njësia	Gjatësia e rrjetit te Kanalizimit
Mitrovicë	164.00 km
Vushtrri	100.71 km
Skenderaj	17.49 km
Totali	282.20 km

Shenim: Aktualisht mungojnë informata rreth rrjetit të ujit dhe kanalizimit në komunat veriore.




Figura 3. Rrjeti primar dhe sekondar i ujit pa pjesen Veriore

Kompania po zbaton projektet për:

- Segmentimin e rrjetit në zona DMA,
- Instalimin e sistemit SCADA për monitorim në kohë reale,
- dhe projektin rajonal për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura Mitrovicë–Vushtrri.

Kapaciteti aktual i prodhimit të ujit siguron mbulueshmëri të plotë për popullsinë, megjithëse sfida mbetet reduktimi i humbjeve të ujit (NRË) dhe efikasiteti energjetik.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me komunat në pjesën veriore të Kosovës, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" ka filluar operimin aktiv në këtë zonë, me fokus të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe ofrimin e shërbimeve të standardizuara për qytetarët.

Funksionimi Aktual

Aktualisht kompania jonë ka funksionalizuar strukturën organizative sipas planit operativ të miratuar. Janë të hapura konkurset për pozitat e parashikuara në këtë plan, të cilat do të përforcojnë më tej kapacitetin e shërbimit në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Humbjet e ujit

Zvogëlimi i humbjeve të ujit përfaqëson një nga sfidat më të mëdha për kompaninë, duke qenë se mbi gjysma e ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në sistem mbetet e pafaturuar. Kjo përfshin humbje fizike, si rrjedhjet nga gypat, dhe humbje komerciale, si gabimet në matje dhe lidhjet (shfrytëzimet) ilegale, të cilat janë faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë fenomen. Ky nivel i lartë i humbjeve jo vetëm që shkakton humbje financiare për kompaninë, por ndikon edhe në cilësinë e furnizimit për konsumatorët, duke krijuar ndërprerje në furnizim dhe duke rrezikuar cilësinë e ujit, që mund të përbëjë një kërcënim për shëndetin e popullatës.

Për të përmbushur objektivin e zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe për të përmirësuar efikasitetin operacional, kompania do të përqendrohet në aktivitetet e mëposhtme:

- Identifikimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).
- Ndërtimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit për të garantuar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm.
- Mbulimi i plotë i konsumatorëve me ujëmatës, në koordinim me departamentin komercial, për të siguruar matje të saktë dhe të drejtë të konsumit.
- Rritja e efikasitetit operativ për të optimizuar proceset dhe për të ulur kostot e lidhura me humbjet e ujit.

Këto aktivitete kontribuojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, si zvogëlimi i humbjeve të ujit, përmirësimi i efikasitetit operacional dhe rritja e cilësisë së furnizimit, duke u përpjekur për një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor për konsumatorët.

Mbulueshmëria me shërbime

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë Statistikore të Kosovës për popullsinë, menaxhmenti i kompanisë vlerëson se deri në vitin 2028, do të ketë një rritje të numrit të ekonomive familjare (konsumatorëve shtëpiak) në regjion. Kjo rritje do të rezultojë në një kërkesë të shtuar për ujë të pijshëm. Me kapacitetet aktuale të Impianteve të Trajtimit të Ujit në Shipol, Balinc dhe Zubin Potok, kompania është e përgatitur për të përballuar rritjen e pritur të kërkesës për ujë të pijshëm. Kapacitetet e këtyre impianteve mund të menaxhojnë me efikasitet furnizimin e nevojshëm për konsumatorët e rinj e atë gjithmonë duke siguruar një cilësi të lartë të shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Këto hapa strategjikë do të ndihmojnë KRU Mitrovica Sh.A. që të sigurojë shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë regjionin dhe të përmbushë nevojat në rritje të konsumatorëve të saj.

Duke u bazuar në të dhënat e lartpërmendura parashikohet se deri në fund të vitit 2028 përqindja e mbulimit me shërbime të furnizimit me rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit do të jetë:

Me furnizim me ujë, mbi 95 % e regionit të Mitrovicës dhe me rrjet të kanalizimit mbi 85 %.

Trajtimi i ujërave të ndotura do të rritet deri 65 %, marrë për bazë planifikimin e ndërtimit të Impiantit të ri për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) dhe kolektorëve kryesor dhe rrjetit sekondar të ujërave të ndotura që do të ndërtohet në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Mitrovicës Veriore dhe Zveçanit.

Zbulimi i rrjedhjeve

Me qëllim të realizimit të objektivave të ndërmarrjes, do të intensifikojmë kërkimet në zbulimin e rrjedhjeve sidomos gjatë orëve të natës kur nëpër lokacione të ndryshme nuk ka zhurmë, konsumi i ujit është shumë i ulët, ndërsa presioni i ujit në tubacion i lartë gjë që e bënë më të lehtë zbulimin e rrjedhjeve nëntokësore, përmes pajisjeve zbuluese akustike. Ky aktivitet do të kryhet përmes caktimit të zonave tek të cilat dyshohet se ka shpenzim të lartë të ujit të pijes.

Prodhimi & Operimi në Impiante

Impiantet për trajtimin e ujit në Shipol, Balinc dhe Zubin Potok, parashihet që të vazhdojnë operimin e tyre normal. Impiantet e trajtimit të ujit, të gjithë qytetarëve të vet u garantojnë ujë cilësor, gjë e cila vërtetohet në bazë të analizave që kryhen në ITU si dhe verifikohen/konfirmohen nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP).

Përmes synimeve tona të lartcekura, planifikojmë uljen e kapaciteteve tona prodhuese duke mos cenuar në asnjë moment cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Tabela 5. Kapacitetet prodhuese sipas ITU-ve

	Maksimal	Planifikim	Maksimal	Planifikim	Maksimal	Planifikim
ITU në Shipol	700 l/s	600 l/s	700 l/s	590 l/s	700 l/s	590 l/s
ITU në Vushtrri	300 l/s	200 l/s	300 l/s	190 l/s	300 l/s	190 l/s
ITU Zubin Potok	160 l/s	150l/s	160l/s	150l/s	160l/s	150l/s
Leposaviq	30 l/s	30l/s	30l/s	30l/s	30l/s	30l/s
Total	1,030 l/s	980 l/s	1,190 l/s	960 l/s	1,190 l/s	960 l/s

Cilësia e ujit të pijshëm në zonën e mbulimit të KRU “Mitrovica” Sh.A. është përgjithësisht brenda standardeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor, duke garantuar që konsumatorët furnizohen me ujë të sigurt dhe të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme. Analizat fiziko-kimike kryhen çdo katër orë në laboratorët e

Impianteve të Trajtimit të Ujit (ITU) në Shipol, Balincë dhe Zubin Potok, ku monitorohen parametra si era, shija, turbullira, ngjyra, pH, klori i lirë, amoniaku, nitracet, nitritet, metale të rënda dhe përçueshmëria elektrike. Rezultatet e këtyre analizave konfirmojnë se të gjithë treguesit janë brenda kufijve të lejuar për ujë të pijshëm, pa devijime që do të rrezikonin shëndetin publik. Përveç kontrollit të brendshëm, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) monitoron në mënyrë të pavarur parametrat bakteriologjikë dhe fiziko-kimikë përmes mostrimit të ujit në pika të ndryshme të rrjetit, duke përfshirë edhe njësitë e reja veriore. Kjo bashkëpunim ndërinstitucional siguron një sistem të dyfishtë verifikimi, i cili rrit besueshmërinë e të dhënave dhe garanton transparencë ndaj publikut.

Në aspektin teknik, sistemi i monitorimit është në proces modernizimi përmes integritit të platformës SCADA, e cila mundëson mbikëqyrje online të parametrave si pH, temperatura, turbullira dhe klori i lirë në kohë reale. Po ashtu, KRU “Mitrovica” ka paraparë abonimin me sistemin LIMS (Laboratory Information Management System), i cili do të sigurojë ruajtje, analizë dhe raportim të centralizuar të të dhënave laboratorike. Në kuadër të planit zhvillimor, ndërmarrja po punon për rifunksionalizimin e laboratorit qendror në Shipol dhe akreditimin e tij për parametrat kryesorë të cilësisë, si dhe për pajisjen e laboratorit mikrobiologjik me aparaturë të re dhe reagjentë specifikë. Këto masa do të mundësojnë realizimin e analizave të plota bakteriologjike brenda kompanisë, duke reduktuar varësinë nga institucionet e jashtme dhe duke përmirësuar shpejtësinë e reagimit në rastet emergjente. Në përfundim, cilësia e ujit të ofruar nga KRU “Mitrovica” është e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet ligjore. Megjithatë, përmirësimet e planifikuara në laboratorët e brendshëm, digjitalizimi i sistemit të monitorimit dhe akreditimi i laboratorit qendror pritet të rrisin më tej efikasitetin, transparencën dhe besueshmërinë në garantimin e ujit të pijshëm për të gjithë konsumatorët e rajonit.

3.3. Analiza financiare

Rezultatet 9-mujore të vitit 2025 paraqesin një performancë të qëndrueshme financiare dhe komerciale për KRU “Mitrovica”, me indikatorë kyç që tregojnë stabilitet të të hyrave dhe kontroll të mirë të shpenzimeve operative. Faturimi total i ujit ka arritur 4.65 milionë € pa TVSH (5.03 milionë € me TVSH), që përfaqëson një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet paraprake, duke reflektuar rritjen e konsumit të faturuar. Arkëtimi nga shërbimet bazë ka arritur 4.12 milionë €, që përbën 82% të faturimit, një nivel i mirë duke marrë parasysh që në Veri të vendit deri për këtë 9 muor është faturuar me shumicë dhe nuk kemi arkëtkuar fare. Ky tregues do të përmirësohet gradualisht me stabilizimin e operimit dhe shtrirjen e kontrolleve në terren.

Në anën e shpenzimeve, totali prej 3.63 milionë € është në përputhje me planifikimet vjetore, me dy kategori dominante: pagat (1.99 milionë €) dhe energjia elektrike (0.90 milionë €). Rritja e kostove të energjisë mbetet një faktor i rëndësishëm presioni financiar, ndërsa shpenzimet tjera operative (derivatet, mirëmbajtja, kimikatet dhe shpenzimet administrative) janë menaxhuar brenda kufijve të planifikuar. Uji i pa faturuar qëndron në nivelin 48%, që është në linjë me objektivin e vitit dhe pasqyron ende efektet e infrastruktures së amortizuar. Pavarësisht këtij faktori sfidues, performanca

financiare ka mbetur pozitive, e dëshmuar nga mbulimi operativ 113%, që nënkupton se të hyrat e arkëtuara kanë qenë të mjaftueshme jo vetëm për të mbuluar shpenzimet operative, por edhe për të krijuar teprice financiare.

Në përgjithësi, rezultati financiar 9-mujor i vitit 2025 është i qëndrueshëm dhe në përputhje me pritjet e planit të biznesit, duke dëshmuar se ndërmarrja ka ndërtuar një bazë solide për performancë të lartë në tremujorin e fundit dhe në vitet pasuese.

3.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SWOT dhe metodologjinë e katër faktorëve; fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Këta faktorë kanë të bëjnë me rritjen e kompanisë, produkteve, shërbimeve dhe objektivave të kompanisë në konkurrencën e tregut. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm: përparësitë dhe dobësitë dhe kanë të bëjnë me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj, kurse dy faktorët tjerë: mundësitë dhe rreziqet paraqesin faktorët e jashtëm dhe të njëjtit varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura KRUM do të tentoj të minimizoj dobësitë dhe rreziqet, duke përmirësuar në vazhdim teknologjinë e punës, avancuar/trajnuar stafin, qasje të vazhdueshme proaktive ndaj borgjlinjeve, etj., e po ashtu të maksimizoj përparësitë dhe mundësitë duke përmirësuar dhe zgjeruar në vazhdim shërbimin ndaj konsumatorit, duke ofruar mundësi zhvillimi profesional përmes punës praktike dhe punësimit për kuadrot e reja dhe profesionale.

Përparësitë:

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit,
- Infrastruktura të trashëguar të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Operatori i vetëm i licencuar, konsumatorë të besueshëm, shitje të garantuar,
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese; Impianti në Shipol dhe Balinc dhe Zubin Potok.

Dobësitë:

- Teknologji e vjetërsuar,
- Moshë e shtyrë e fuqisë punëtore,
- Konsumi i ujit në Veri dhe mopesa e tij,
- Humbjet e mëdha teknike dhe komerciale,

Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve,
- Mbështetje nga Partnerët,
- Zhvillimin e shërbimeve të reja lehtësuese për konsumatorin,
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit,

-
- Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit të ujit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave,
 - Bazë e mirë ligjore për procedim të lëndëve të ndryshme në Gjykatë apo përmes Përmbauesve Privat,
 - Infrastrukturë ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU),

Rreziqet:

- Ngritja e tensioneve sociale apo politike,
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.),
- Vjetërsia e rrjetit,
- Gjendja e vështirë ekonomike dhe niveli i lartë i rasteve sociale në regjionin e Mitrovicës,
- Llogaritë e arkëtueshme të larta.

4. VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

4.1. Vizioni

KRU “Mitrovica” synon të jetë një kompani moderne dhe e qëndrueshme që garanton furnizim të sigurt, cilësor dhe të pandërprerë me ujë të pijshëm, si dhe menaxhim efikas të ujërave të ndotura në përputhje me standardet më të larta të Bashkimit Evropian. Duke integruar teknologji të avancuara për trajtim dhe monitorim në kohë reale, kompania angazhohet për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e cilësisë së lartë të ujit për çdo konsumator.

Si pjesë e Rajonit të Ujit të Danubit, KRU “Mitrovica” është e përkushtuar të zbatojë praktikatat më të mira evropiane, të nxisë inovacionin dhe të përmirësojë vazhdimisht shërbimet ndaj konsumatorëve, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

4.2. Misioni

Të sigurojmë furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm, menaxhim efikas të ujërave të ndotura dhe mbrojtje të burimeve ujore, përmes operimit profesional, transparencës, përgjegjësisë sociale dhe përfshirjes së komunitetit.

4.3. Vlerat Themelore

Vlerat themelore të KRU “Mitrovica” përfaqësojnë bazën mbi të cilën ndërtohet çdo veprim, vendim dhe strategji e kompanisë. Në qendër të këtyre vlerave qëndron integriteti, që udhëheq mënyrën e menaxhimit dhe shërbimit publik me ndershmëri, transparencë dhe përgjegjësi. Profesionalizmi është themeli i performancës së lartë, duke u bazuar në kompetencë, përkushtim dhe efikasitet në çdo nivel organizativ. Inovacioni dhe përmirësimi i vazhdueshëm udhëheqin zhvillimin teknologjik dhe operacional, duke nxitur digjitalizimin dhe përdorimin e praktikave bashkëkohore në menaxhimin e ujit dhe ujërave të ndotura. Po ashtu, ndërmarrja promovon bashkëpunimin dhe respektin reciprok, si brenda stafit ashtu edhe me konsumatorët, partnerët dhe institucionet, duke ndërtuar marrëdhënie të bazuara në besim dhe komunikim të hapur. Një nga vlerat kyçe mbetet përgjegjësia shoqërore dhe mjedisore, përmes së cilës KRU “Mitrovica” synon të mbrojë burimet natyrore, të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe të sigurojë një shërbim publik që reflekton etikë, kujdes dhe respekt ndaj qytetarëve dhe mjedisit

4.4. Objektivat Strategjikë

- objektivate strategjike për vitin 2026 si vijon:
- Zvogëlimin e shkallës së ujit të pa faturuar në 58 %
- Cilësinë e ujit të pijes sipas standardeve,

- Mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin e ujit dhe kanalizimit, me qëllim të ofrimit të një shërbimi sa më cilësor,
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 88 %
- Ngritjen e normës së punës në 1.20
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.00
- Integrimin dhe shtrirjen e plotë në zonën e shërbimit të Komunave veriore

Shënim: Si rezultat i integritit të komunave veriore dhe mungesës së informatave rreth infrastrukturës gjatë fazës së tranzicionit, vlerësohet se niveli i ujit të pafaturuar në vitin 2026 do të jetë më i lartë krahasuar me vitin aktual.

5. STRATEGJITË KRYESORE ZHVILLIMORE

Strategjia e zhvillimit të KRU “Mitrovica” për periudhën 2026–2028 mbështetet në pesë shtylla themelore të cilat përfaqësojnë boshtin e menaxhimit modern të ndërmarrjes: strategjia financiare, teknike, për konsumatorët, për burimet njerëzore dhe për inovacionin digjital.

5.1. Strategjia Financiare

Në kuadër të objektivave të përgjithshme të ndërmarrjes për periudhën 2026–2028, Departamenti i Financave do të zbatojë një strategji të orientuar drejt stabilitetit dhe vetëqëndrueshmërisë financiare, me synim garantimin e ekuilibrit afatgjatë ndërmjet të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve kapitale. Strategjia përfshinë masa konkrete për eliminimin e gjetjeve të auditorëve, përmes forcimit të kontrollit të brendshëm financiar, përmirësimit të procesve në kontabilitet dhe financa dhe zbatimit të plotë të rekomandimeve të auditimit.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme është përmirësimi i procedurave që lidhen me financat, me qëllim standardizimin e praktikave buxhetore dhe rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve. Po ashtu, departamenti do të investojë në avancimin e sistemit të softuerit financiar dhe kontabël, për të mundësuar automatizim të proceseve, integrim të modulit të asetëve dhe raportim më të saktë në kohë reale. Në të njëjtën linjë, do të thellohet menaxhimi profesional i asetëve, përmes regjistrimit, kontrollit dhe rivlerësimit periodik sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IAS/IFRS).

5.2. Strategjia Teknike dhe Operative

Kjo strategji synon rritjen e efikasitetit të rrjetit dhe uljen e humbjeve përmes investimeve në teknologji moderne dhe mirëmbajtjes preventive.

Prioritetet kryesore janë:

- Të hartohen dhe zbatohen projektet prioritare sipas Planit të Investimeve 2026–2028.

- Implementimi i sistemit SCADA për monitorim në kohë reale të presionit, fluksit dhe prishjeve në rrjet;
- Përdorimi i sistemit GIS për hartëzimin e rrjetit dhe menaxhimin e aseteve;
- Instalimi i ujëmatësave inteligjentë për konsumatorët dhe zonat DMA, për reduktimin e ujit të pafaturuar;
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues dhe ndërtimi i linjave të reja për zonat e sapo integruara në veri;
- Zhvillimi i sistemeve të kontrollit të konsumit energjetik nëpër stacione pompimi.
- Të përditësohet dhe zbatohet Plani i Menaxhimit të Aseteve (PMA) si dokument bazë për prioritetet investive të viteve 2026–2028.
- Të kryhet inventarizimi dhe digjitalizimi i plotë i aseteve teknike në GIS.
- Të harmonizohen të dhënat me ARRU dhe me raportimet e performancës (KPI).
- Të monitorohet zbatimi teknik dhe financiar i projekteve sipas standardeve të prokurimit publik dhe kërkesave të BE-së.)
- Kalimi i mirëmbajtjes elektromakinere në kontraktim të jashtëm.

5.3. Strategjia për Konsumatorët

Në kuadër të objektivave strategjike deri në përfundim të vitit 2028, KRU “Mitrovica” Sh.A. ka përcaktuar një strategji të qartë për përmirësimin e marrëdhënieve me konsumatorët, duke u bazuar në parimet e transparencës, shërbimit cilësor dhe bashkëpunimit afatgjatë. Fokusi kryesor është rritja e kënaqësisë së konsumatorëve dhe sigurimi i shërbimeve të standardizuara në të gjitha njësitë operative. Strategjia synon përfshirjen e plotë të konsumatorëve në proceset e menaxhimit të ujit, duke i informuar dhe vetëdijësuar për rëndësinë e pagesave të rregullta dhe raportimit të defekteve në rrjet.

Në aspektin operativ, kompania do të zbatojë:

- Digjitalizimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, përmes platformës online për pagesa, komunikim dhe raporte.
- Zgjerimin e mbulueshmërisë me ujëmatës, për të garantuar faturim të drejtë dhe transparent sipas konsumit real.
- Fushata ndërgjegjësimi për konsumatorët në zonat e reja të integruara, me theks në pagesën e rregullt të faturave dhe kujdesin ndaj rrjetit publik.
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe reagimit ndaj kërkesave, duke reduktuar kohën mesatare të trajtimit të ankesave dhe ndërprerjeve.
- Zhvillimin e një baze të dhënash të integruar të konsumatorëve, për analizë të sjelljes së konsumit dhe identifikim të zonave me performancë të ulët.

Strategjia synon që deri në fund të vitit 2028, të arrihet një shkallë arkëtimi prej 99% për pjesën jugore duke përfshi borxhet, të sigurohet faturim i drejtë dhe gjithëpërfshirës, si dhe të përforcohet besimi i konsumatorëve përmes një komunikimi të hapur dhe shërbimeve digjitale efikase.

5.4. Strategjia për Burimet Njerëzore

KRU “Mitrovica” Sh.A. synon zhvillimin e një sistemi modern dhe funksional për burimet njerëzore, në përputhje me zgjerimin operacional dhe nevojat strategjike.

Strategjitë kryesore përfshijnë:

- Zhvillimin profesional të vazhdueshëm dhe ngritjen e kapaciteteve përmes programeve të trajnimeve të strukturuar, të përshtatura me nevojat e stafit.
- Zgjerimin e stafit në përputhje me rritjen e zonës operative, duke siguruar një përbërje të qëndrueshme dhe të kualifikuar të punonjësve.
- Përmirësimin e efikasitetit përmes automatizimit të proceseve BNj dhe përforcimit të kapaciteteve në këtë sektor me staf administrativ shtesë.
- Përmirësimin e performancës përmes sistemeve të kompensimit të drejtë dhe mekanizmave motivues që burojnë nga vlerësimi i rezultateve.
- Inkurajimin e barazisë gjinore dhe përfshirjes më aktive të grave në pozita të ndryshme brenda kompanisë.
- Në këtë mënyrë, KRU “Mitrovica” synon të ndërtojë një kulturë organizative të orientuar drejt performancës, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

5.5. Strategjia për Inovacion dhe Digjitalizim

KRU “Mitrovica” Sh.A. synon të avancojë drejt një modeli modern operimi përmes zbatimit të teknologjive inteligjente dhe proceseve të automatizuara që rrisin efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve. Në këtë kuadër, strategjia e digjitalizimit bazohet në pesë drejtime kryesore zhvillimore:

Digjitalizimi i proceseve operative: Zbatimi i sistemeve moderne SCADA për monitorim dhe kontroll në kohë reale të impianteve të ujit, automatizimi i pompave, valvulave dhe matësve të presionit, me qëllim rritjen e efikasitetit energjetik dhe uljen e humbjeve operative.

Transformimi digjital i shërbimeve ndaj konsumatorëve: Krijimi i një platforme online të integruar për faturim, pagesa elektronike dhe komunikim dypalësh me konsumatorët, duke mundësuar transparencë, akses më të lehtë në informacione dhe shërbim të personalizuar.

Menaxhimi inteligjent i rrjetit të ujësjellësit: Implementimi i matësve inteligjentë (smart meters) dhe përdorimi i GIS për monitorimin e rrjetit, identifikimin e humbjeve dhe optimizimin e shpërndarjes së ujit në kohë reale.

Përmirësimi i vendimmarrjes përmes analizës së të dhënave: Krijimi i një baze të integruar të të dhënave operacionale dhe financiare, si dhe zhvillimi i mjeteve analitike dhe raporteve dinamike për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe planifikimit afatgjatë.

Inovacion në menaxhim dhe zhvillim të kapaciteteve: Investime të vazhdueshme në trajnimin e stafit teknik dhe administrativ, bashkëpunim me institucione akademike, donatorë ndërkombëtarë dhe partnerë teknologjikë, për të nxitur kulturën e inovacionit dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm institucional.

5.6 STRATEGJIA E INTEGRIMIT TË KOMUNAVE VERIORE

Në kuadër të zgjerimit të zonës së operimit dhe forcimit të rolit institucional të ndërmarrjes, KRU “Mitrovica” Sh.A. ka integruar në menaxhim komunat Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, në përputhje me licencën e zgjeruar të ARRU-së dhe marrëveshjet institucionale të bashkëpunimit. Ky proces paraqet një nga zhvillimet më të rëndësishme strategjike të ndërmarrjes në periudhën 2026–2028 dhe ndërlidhet drejtpërdrejt me objektivat e Planit të Biznesit, qëndrueshmërinë financiare, zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime dhe përmirësimin e performancës operative.

Strategjia e integrimit është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

- funksionalizimin institucional dhe operacional të njësive veriore;
- integrimin teknik, financiar dhe komercial në sistemin ekzistues të KRU “Mitrovica”;
- krijimin e një modeli të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimeve publike në përputhje me standardet e ARRU-së dhe praktikrat e ndërmarrjes.

Në aspektin organizativ, ndërmarrja ka përfshirë njësitë operative veriore në strukturën zyrtare organizative dhe ka planifikuar zgjerimin e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe administrative për të siguruar operim të qëndrueshëm në terren. Për këtë qëllim janë planifikuar rekrutime të stafit operativ, teknik dhe menaxherial, integrimi i proceseve në sistemet ekzistuese të kompanisë, si dhe standardizimi i procedurave operative dhe administrative.

Në aspektin teknik dhe investiv, strategjia parasheh rehabilitimin gradual të infrastrukturës ekzistuese, reduktimin e humbjeve të ujit, zgjerimin e sistemit SCADA dhe GIS, instalimin e ujëmatësve, përmirësimin e monitorimit të rrjetit dhe investime prioritare në impiantet dhe objektet operative në veri. Këto masa synojnë rritjen e efikasitetit operacional, përmirësimin e cilësisë së furnizimit dhe krijimin e bazës për qëndrueshmëri afatgjate të sistemit.

Në aspektin komercial dhe financiar, integrimi përfshin kalimin nga modeli i faturimit me shumicë në faturim individual për konsumatorët finalë, regjistrimin dhe azhurnimin e bazës së konsumatorëve, instalimin e matësve dhe krijimin gradual të disiplinës tarifore. Ky proces lidhet drejtpërdrejt me objektivat strategjike të ndërmarrjes për rritjen e arkëtimit, reduktimin e humbjeve komerciale dhe forcimin e vetëqëndrueshmërisë financiare.

Integrimi i komunave veriore ndikon drejtpërdrejt edhe në menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjes. Për shkak të specifikave operative, politike dhe financiare në veri, ndërmarrja ka identifikuar rreziqe të ndërlidhura me inkasimin, humbjet komerciale, kostot operative, investimet kapitale dhe stabilitetin financiar. Për këtë arsye, strategjia e integrimit është ndërlidhur drejtpërdrejt me kapitullin e menaxhimit të rreziqeve dhe planifikimit financiar të ndërmarrjes.

Në kuadër të Planit të Biznesit 2026–2028, integrimi i komunave veriore konsiderohet prioritet strategjik dhe institucional i ndërmarrjes, me ndikim të drejtpërdrejtë në:

- zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime;
- rritjen e numrit të konsumatorëve;
- zhvillimin e investimeve kapitale;
- rritjen e performancës operative dhe komerciale;
- forcimin e rolit institucional të KRU “Mitrovica” në nivel regjional.

Për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe monitorim efektiv të këtij procesi, aktivitetet e integritetit do të monitorohen në baza periodike nga Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve, përmes indikatorëve kyç të performancës, raportimit operacional dhe vlerësimit të vazhdueshëm të rreziqeve operative, financiare dhe fiskale.

6. PLANI OPERACIONAL / ZHVILLIMOR

Plani operacional për periudhën 2026–2028 përfaqëson dokumentin udhëzues të zhvillimit të ndërmarrjes, i cili përcakton drejtimit konkrete të veprimit për secilin departament, në përputhje me objektivat strategjike të kompanisë dhe me sfidat aktuale të sektorit të ujësjellësit në Kosovë. Ky plan synon të ruajë balancën midis qëndrueshmërisë financiare, modernizimit teknologjik dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke integruar veprimet e departamenteve financiare, teknike, komerciale, të burimeve njerëzore dhe të inovacionit në një strategji të unifikuar institucionale.

Në kuadër të planit operacional, parashihet ristrukturimi i njësisë së burimeve njerëzore dhe integrimi i saj në një sistem të digjitalizuar të menaxhimit të stafit (HRIS), që do të mundësojë automatizimin e rekrutimeve, administrimin e pushimeve, menaxhimin e pagave, trajnimeve dhe vlerësimeve të performancës. Ky sistem do të lidhë drejtpërdrejt të dhënat e stafit me proceset financiare dhe operative të ndërmarrjes, duke mundësuar kontroll më të mirë të kostove të punës dhe planifikim të qëndrueshëm afatgjatë.

Në aspektin e kapaciteteve njerëzore, gjatë viteve 2026–2028 planifikohet përmbushja e kërkesave emergjente për rekrutime në sektorët teknikë, laboratorikë dhe menaxherialë, me theks të veçantë në mbulimin e njësive veriore. Po ashtu, për shkak të pensionimeve dhe ndryshimeve strukturore, do të realizohen zëvendësime për pozitat kritike që garantojnë funksionimin e vazhdueshëm të rrjetit dhe laboratorëve. Këto rekrutime janë të domosdoshme për të siguruar qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve dhe ruajtjen e cilësisë së lartë të ujit të pijshëm.

Trajnimet profesionale mbeten boshti kryesor i zhvillimit të kapaciteteve. Për këtë qëllim, është planifikuar një buxhet vjetor prej 50,000 €, i shpërndarë si vijon:

Tabela 6. Buxheti sipas departamenteve

TRAJNIMI	BUXHETI/€
Departamenti Administrativ	10,000
Departamenti Teknik	12,000
IT	4,000
Cilësia e ujit	3,000
Departamenti Komercial	11,000
Departamenti Financiar	8,500
Njësia e Auditimit	1,500
Totali I Përgjithshëm	50,000

Këto fonde do të përdoren për zhvillimin e programeve të trajnimit në: sigurinë teknike dhe mjedisore, operimin e sistemeve SCADA dhe GIS, mirëmbajtjen elektro-mekanike, teknikat laboratorike, përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve, menaxhimin financiar sipas standardeve ndërkombëtare (IFRS), si dhe trajnime menaxheriale për drejtuesit e njësive operative etj. Në mënyrë të veçantë, do të promovohet kultura e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, përmes bashkëpunimeve me institucione arsimore dhe donatorë ndërkombëtarë, duke siguruar certifikime për stafin teknik dhe administrativ. Kjo qasje do të mundësojë jo vetëm ngritje të kompetencave individuale, por edhe përmirësim të efikasitetit organizativ, rritje të produktivitetit dhe ulje të kostove operacionale në planin afatgjatë. Në përfundim, periudha 2026–2028 do të përfaqësojë një fazë transformuese për menaxhimin e burimeve njerëzore në KRU “Mitrovica”, duke kaluar nga administrimi tradicional drejt një modeli modern të zhvillimit të stafit, të integruar, të digjitalizuar dhe të orientuar drejt performancës dhe rezultateve të matshme.

Gjatë vitit 2026, ndërmarrja do të fokusohet edhe në konsolidimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale, me theks të veçantë në digjitalizimin e proceseve dhe automatizimin e sistemit të operimit. Paralelisht, do të nisë zhvillimi i platformës digjitale për faturim, komunikim dhe pagesa online për konsumatorët, një reformë që do të modernizojë marrëdhënien ndërmjet kompanisë dhe konsumatorit, veçanërisht në zonat veriore ku ndërmarrja është tashmë operative. Në kuadër të vitit të parë të planit, parashihet gjithashtu fillimi i programit për matjen inteligjente të konsumit (DMA), duke nisur me dy zona pilot që do të shërbejnë si model për gjithë rrjetin. Departamenti i Financave do të implementojë sistemin e ri ERP për integrimin e plotë të raportimit dhe menaxhimit financiar, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe duke eliminuar gjetjet e auditimit të jashtëm. Në të njëjtën periudhë, përmes trajnimeve të stafit dhe përmirësimit të procedurave kontabël.

Viti 2027 do të përfaqësojë fazën e zgjerimit dhe integritit operacional në të gjitha njësitë e kompanisë, përfshirë ato të sapo shtuara në veri të vendit. Po në këtë vit do të intensifikohet përdorimi i pajisjeve të matjes gjeodezike dhe softuerëve të analizës teknike (GIS/SCADA) për menaxhimin më efikas të rrjetit. Departamenti Komercial do të ketë rol kyç në integrimin e konsumatorëve veriorë në sistemin e faturimit individual dhe në forcimin e disiplinës së pagesave, duke synuar një nivel arkëtimi prej 98% të faturimit dhe reduktimin e ujit të pa faturuar në 46%. Në aspektin financiar, do të zhvillohet raportimi në kohë reale përmes sistemit ERP dhe do të publikohet performanca financiare në baza tremujore për të rritur transparencën publike dhe besimin

institucional. Njëkohësisht, Departamenti i Burimeve Njerëzore do të zhvillojë një cikël të gjerë trajnimesh profesionale për stafin teknik dhe administrativ, me theks në përdorimin e sistemeve digjitale të menaxhimit dhe në ngritjen e kompetencave për mirëmbajtjen e rrjeteve SCADA dhe GIS. Kjo do të shoqërohet me përmirësimin e strukturës organizative, veçanërisht në njësitë veriore, për të krijuar një balancë më të mirë ndërmjet kërkesave operative dhe burimeve njerëzore në dispozicion.

Gjatë vitit 2028, fokusi i ndërmarrjes do të jetë konsolidimi i arritur dhe sigurimi i vetëqëndrueshmërisë së plotë financiare dhe teknike. Pritet përfundimi i fazës së dytë të instalimit të ujëmatësve, duke arritur mbulueshmëri të plotë për të gjithë konsumatorët aktivë. Po ashtu, pritët finalizimi i fazës së parë të funksionimit të Impiantit Rajonal të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, projekt ky me ndikim të madh mjedisor dhe ekonomik që do të ulë ndjeshëm ndotjen e lumenjve dhe do të përmirësojë kushtet e jetesës për mbi 200,000 banorë të rajonit. Në këtë fazë do të arrihet ulja e humbjeve të ujit si dhe stabilizimi i plotë i kostove të energjisë përmes implementimit të projekteve fotovoltaike dhe të eficiencës energjetike. Departamenti i Financave do të udhëheqë procesin e konsolidimit buxhetor, me ulje të shpenzimeve operative dhe ruajtje të mbulueshmërisë mbi 120%, ndërsa Departamenti Komercial do të avancojë me transparencë të plotë përmes publikimit të raporteve tremujore dhe funksionalizimit të qendrës së integruar të shërbimeve ndaj konsumatorëve (One-Stop Service).

Në përfundim të periudhës, ndërmarrja do të realizojë një vlerësim të përgjithshëm të performancës institucionale, për të përcaktuar orientimet e reja të zhvillimit për periudhën 2029–2031. Ky vlerësim do të përfshijë analizën e rezultateve financiare, teknike dhe njerëzore, si dhe një rishikim të strategjisë së përgjithshme për përshtatjen me sfidat e tregut të liberalizuar të energjisë dhe me kërkesat gjithnjë në rritje të konsumatorëve. Kështu, përmes këtij plani operacional, KRU “Mitrovica” Sh.A. konfirmon përkushtimin e saj për të ndërtuar një ndërmarrje të qëndrueshme, të digjitalizuar dhe me standarde të larta qeverisjeje, që ofron shërbime të sigurta, të vazhdueshme dhe të barabarta për të gjithë qytetarët e rajonit.

7. PLANI FINANCIAR

Planifikimi financiar për periudhën 2026–2028 reflekton një tranzicion të rëndësishëm në performancën ekonomike të KRU “Mitrovica” Sh.A., i udhëhequr nga reforma tarifore, zgjerimi i zonës së menaxhimit dhe konsolidimi i arkëtimeve. Rritja e të hyrave dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare përbëjnë rezultatet më të rëndësishme të këtij procesi, duke siguruar bazën për vetëfinancim dhe investime të qëndrueshme në infrastrukturë.

Nivelet e reja të çmimeve nominale të tarifave për vitin 2026 kanë shënuar ndryshimin më të madh historik në strukturën e çmimeve të ujit dhe ujërave të ndotura. Draft Tarifat volumetrike për konsumatorët shtëpiakë janë rritur nga 0.39 euro/m³ në 0.5324 euro/m³, ndërsa për konsumatorët komercialë dhe institucionalë nga 0.55 euro/m³ në 0.6921 euro/m³. Kjo rritje justifikohet nga dy faktorë kryesorë: rritja e ndjeshme e kostove të energjisë elektrike dhe përfshirja e komunave veriore në sistemin e menaxhimit, që kanë sjellë rritje të menjëhershme të kostove operative dhe investimeve të nevojshme. Tarifat për ujërat e ndotura, megjithëse më të ulëta nominalisht, janë harmonizuar për të ruajtur balancën ekonomike dhe për të mos rënduar konsumatorët në mënyrë disproporcionale. Si rezultat, tarifa kumulative për konsumatorët shtëpiakë (ujë dhe ujëra të ndotura) arrin në 0.6678 euro/m³, ndërsa për konsumatorët jo-shtëpiakë në 0.99 euro/m³, duke reflektuar mbulimin e plotë të kostove dhe krijimin e një margjine pozitive për investime.

Në aspektin e të hyrave, pasqyra financiare tregon ndërmjet viteve 2025 dhe 2026. Të ardhurat totale rriten nga 7.61 milion euro në 9.59 milion euro. Ky ndryshim është i lidhur kryesisht me rritjen e të hyrave nga shitja e ujit, nga 6.19 milion euro në 8.15 milion euro si rezultat i aplikimit të tarifave të reja dhe rritjes së faturimit të metrave volumetrike. Të hyrat nga donacionet dhe grantet ruajnë stabilitet, ndërsa subvencionet direkte eliminohen duke treguar se ndërmarrja hyn në një fazë vetëqëndrueshmërie financiare pa nevojë për mbështetje operative nga buxheti i shtetit. Një element thelbësor në këtë rritje është fakti se faturimi për komunat veriore, i cili më parë realizohej si faturim i ujit me shumicë, tashmë do të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore për konsum individual të konsumatorëve fundorë. Kjo qasje e re jo vetëm që siguron barazi tarifore në gjithë zonën e licencës, por edhe vendos bazat për integrim të plotë të veriut në sistemin financiar e operacional të ndërmarrjes.

Në anën tjetër, shpenzimet operative janë planifikuar me kujdes, duke reflektuar rritje të arsyeshme në përputhje me zgjerimin e shërbimeve. Totali i shpenzimeve operative rritet nga 8.12 milion euro në 10.51 milion euro, që përfaqëson një rritje prej 30%. Pjesa më e madhe e rritjes lidhet me shpenzimet për paga dhe kontribute, të cilat rriten për shkak të përfshirjes së komunave të reja dhe nevojës për staf shtesë. Shpenzimet për energjinë elektrike përbëjnë elementin me ndikimin më të madh, duke u rritur nga 1.85 milion euro në 3.0 milion euro, çka dëshmon rëndësinë që ka pasur tregu i lirë i energjisë në përcaktimin e tarifave të reja. Ndërkohë, kostot për mirëmbajtje, kimikate, karburante dhe komunikim janë mbajtur nën kontroll përmes politikave të efikasitetit operacional.

Performanca e arkëtimeve është një tjetër tregues pozitiv i këtij plani. Në vitin 2025, norma e arkëtimit ishte 80%, ndërsa për vitin 2026 parashikohet të arrijë në 102%, duke synuar 106% deri në vitin 2028. Kjo përmirësim i ndjeshëm bazohet në dy politika të veçanta: për njësitë jugore (Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj) është aplikuar një normë inkasimi prej 105% të faturimit, përfshirë edhe

borxhet e akumuluar nga vitet e kaluara; ndërsa për njësitë veriore, të cilat për herë të parë po përfshihen në sistemin e faturimit, është parashikuar një normë inkasimi prej 80% e faturimit mirëpo me një rregullim për TM1 duke mos pritur faturim dhe inkasim si dhe për TM2 duke inkasuar 50% të asaj të faturuar, duke marrë parasysh nevojën për integrim gradual dhe edukim të konsumatorëve në kulturën e pagesës. Kjo qasje e diferencuar e bën planin më realist dhe siguron ruajtjen e likuiditetit në fazën e tranzicionit institucional.

Të gjitha detajet numerike dhe pasqyrat përkatëse paraqiten në tabelat financiare të planit për vitet 2025–2028, të cilat shërbejnë si bazë për analizat e mësipërme.

Tabela 7. Tarifat

Nivelet e çmimeve nominale të tarifave	Njësia	2025	2026
Ujë			
Shtëpiak –volumetrike	EUR/m3	0.39	0.5324
Komerical-industrial-volumetrike	EUR/m3	0.55	0.6291
Institucional-volumetrike	EUR/m3	0.55	0.6291
Ujërat e zeza (vëllimi i ujit të konsumuar)			
Shtëpiak	EUR/m3	0.1	0.1354
Komerical-industrial	EUR/m3	0.22	0.2979
Institucional	EUR/m3	0.22	0.2979
Tarifat komulative			
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	0.49	0.6678
Jo-shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	0.77	0.99

7.1. Të ardhurat dhe shpenzimet operative

Departamenti i Financave i KRU “Mitrovica” Sh.A. është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), duke siguruar transparencë, saktësi dhe krahasueshmëri të të dhënave financiare. Të gjitha librat kontabël, regjistrimet e transaksioneve dhe evidencat tatimore mbahen në përputhje me Legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe me kërkesat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Raportimet financiare realizohen në baza mujore, tremujore dhe vjetore, të cilat i nënshtrohen kontrollit të brendshëm dhe auditimeve të jashtme, duke garantuar besueshmëri në prezantimin e pozitës financiare dhe të performancës së kompanisë.

Tabela 8. Pasqyra e të ardhurave

	2025	2026
	€	€
Të hyrat		
Te hyrat nga shitja e ujit	6,189,490	8,148,580
Te hyrat nga sherbimet	25,424	25,424
Te hyrat nga subvencionet	-	-
Te hyrat nga donacionet(Te hyrat e shtyera)	1,393,801	1,418,801
Total te Hyrat	7,608,714	9,592,805
Kostoja e shitjes	650,000	775,000
Fitimi / (humbja) bruto	6,958,714	8,817,805
Shpenzimet e pagave	2,941,000	4,140,372
Shpenzimet e energjise	1,850,000	3,000,000
Shpenzimet e karburanteve	42,000	45,000
Shpenzimet e mirembajtjes	88,000	110,000
Shpenzimet e komunikimit	10,360	11,700
Sherbimet e jashtme kontraktuese	287,990	262,850
Te tjera	180,142	205,000
Borxhet e Fshira	200,000	200,000
Shpenzimet e zhvleresimit	2,516,895	2,536,895
Total shpenzimet	8,116,387	10,511,817
Fitimi / (humbja) operativ	(1,157,672)	(1,694,012)
Shpenzimet financiare		
Të ardhurat financiare		
Fitimi / (humbja) para tatimit	(1,157,672)	(1,694,012)
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(1,157,672)	(1,694,012)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		

Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave	-	-
financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit	(1,157,672)	(1,694,012)

Analiza e shpenzimeve për periudhën 2025–2028 tregon një strukturë të balancuar dhe të planifikuar në mënyrë të kujdesshme, në përputhje me trendet rritëse të çmimeve në treg dhe me zgjerimin e zonës së shërbimit të KRU “Mitrovica” Sh.A. Për vitin 2025, shpenzimet totale operative arrijnë 6.05 milionë euro, ndërsa për vitin 2026 parashikohet një rritje në 8.6 milionë euro, me rritje graduale deri në 8.68 milionë euro në vitin 2028. Kjo rritje përfaqëson një zgjerim të domosdoshëm operacional si rezultat i njësive të reja veriore (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq), si dhe pasqyrimin e trendeve inflacionare dhe të çmimeve të energjisë elektrike në nivel kombëtar. Dy kategoritë më të rëndësishme të shpenzimeve janë pagat dhe energjia elektrike, të cilat përbëjnë së bashku mbi 80% të totalit të shpenzimeve operative. Pagat përbëjnë mesatarisht 45% të totalit, duke reflektuar nevojën për personel shtesë në njësitë e sapo integruara dhe rritjen e përgjegjësive teknike e administrative. Nga 2.94 milionë euro në vitin 2025, pagat parashikohet të arrijnë në mbi 4.3 milionë euro në vitin 2028, duke ruajtur raportin e kontrolluar me të hyrat e përgjithshme.

Ndërkohë, shpenzimet për energjinë elektrike tregojnë një rritje të ndjeshme, nga 1.85 milionë euro në vitin 2025 në mbi 3.0 milionë euro në 2026, dhe stabilizim në vitet pasuese. Kjo rritje pasqyron efektin e kalimit në tregun e lirë të energjisë dhe marrja në menaxhim e Komunave Veriore. Në kategoritë e tjera, shpenzimet për Iber Lepencin (furnizim me ujë të papërpunuar) mbeten relativisht të qëndrueshme rreth 650 mijë euro në vit, ndërsa mirëmbajtja, kimikatet dhe karburantet përbëjnë pjesën tjetër të strukturës operative. Përkundër rritjes nominale të shpenzimeve, efikasiteti financiar është përmirësuar ndjeshëm: raporti ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve kalon nga. Në përfundim, planifikimi i shpenzimeve është bërë me kujdes, duke pasur parasysh trendin rritës të kostove, inflacionin dhe zgjerimin e zonës së shërbimit.

Tabela 9. Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2026-2028

KATEGORIA	Vitet			
	Faktike & Buxheti 2025	Buxheti 2026	Projektuar 2027	Projektuar 2028
ARKËTIMI				
ARKTËTIMI I PËRGJITHSHËM	6,370,995	9,049,483	9,320,068	9,598,770
Arketimi nga shërbimet baze te ujit	5,309,448	9,019,483	9,290,068	9,568,770
Arketimi nga shërbimet	30,000	30,000	30,000	30,000
SHPENZIMET				
Shpenzimet e pagave	2,941,000	4,140,372	4,223,179	4,307,643

Pagesat per kompenzimin e oreve shtese 2021-2023	110,000	35,000	-	
Shpenzimet e energjise	1,850,000	3,000,000	3,007,500	3,010,508
Shpenzimet e karburanteve	42,000	45,000	45,113	45,158
Shpenzimet e Iber Lepenc-it	550,000	655,000	656,638	657,294
Shpenzimet e kemikaleve	100,000	120,000	120,300	120,420
Shpenzimet e mirembajtjes	88,000	110,000	110,275	110,385
Shpenzimet e komunikimit	10,360	11,700	11,729	11,741
Sherbimet e jashtme kontraktuese	287,990	262,850	150,000	150,150
Te tjera	70,142	270,000	270,675	270,946
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	6,049,492	8,649,922	8,595,409	8,684,245
Diferenca Arketim/Shpenzime	321,503	399,561	724,659	914,525
Investime Kapitale vetanake dhe kontigjenca	(321,503)	(399,561)		
Mbyllja Neto		0	724,659	914,525

Tabela 10. Caqet kryesore të performancës

Të Dhënat dhe Caqet Kryesore të Përformancës	Aktuale dhe e planifikuar	Planifikimi i Performancës në 2026-28		
	2025	2026	2027	2028
D 001 Uji i prodhuar (m3)	27,780,880	31,536,000	31,500,000	29,500,000
D 002 Konsumatorët e regjistruar (të faturuar) (nr.)	70,460	74,883	76,374	77,137
<i>D 002.1 Konsumatorët shtëpiak (nr.)</i>	63,392	67,758	69,178	69,870
<i>D 002.1.1 Konsumatorët shtëpiak me ujematje (nr.)</i>				
<i>D 002.2 Konsumatorët kom. (bisnese) (nr.)</i>	6,442	6,492	6,557	6,622
<i>D 002.2.1 Konsumatorët kom. (bisnese) me ujematje (nr.)</i>				
<i>D 002.3 Konsumatorët kom. (institucione) (nr.)</i>	626	633	639	645
<i>D 002.3.1 Konsumatorët kom. (institucione) me ujematje (nr.)</i>				
D 004 Uji me shumicë i faturuar (m3)	4,191,420	0	0	0
D 005 Uji i faturuar (m3)	9,807,749	11,299,008	11,524,988	11,755,488
<i>D 005.1 Uji i faturuar (amviseri) (m3)</i>	8,032,880	8,525,704	8,696,218	8,870,142
<i>D 005.2 Uji i faturuar (jo-amviseria) (m3)</i>	1,072,269	2,642,504	2,695,354	2,749,261
<i>D 005.2.1 Uji i faturuar për konsum, me ujëmatës (bisnese) (m3)</i>	0	0	0	0
<i>D 005.3 Uji i faturuar (nderkombetare) (m3)</i>	702,600	130,800	133,416	136,084
<i>D 005.3.1 Uji i faturuar për konsum, me ujëmatës (institucione) (m3)</i>	0	0	0	0
D 006 Faturimi (€)	6,678,432	8,800,467	8,976,476	9,066,241

<i>D 006.1 Faturimi për amvisëri (€)</i>	4,571,070	5,882,736	6,000,390	6,060,394
<i>D 006.2 Faturimi për biznese (€)</i>	958,556	2,827,479	2,884,029	2,912,869
<i>D 006.3 Faturimi për institucione (€)</i>	436,265	90,252	92,057	92,978
<i>D 006.3 Faturimi nga uji me shumicë (€)</i>	712,541	0	0	0
D 007 Arkëtimi (€)	5,309,448	9,019,483	9,290,068	9,568,770
<i>D 007.1 Arkëtimi për amvisëri (€)</i>	4,142,594	6,020,861	6,201,487	6,387,531
<i>D 007.2 Arkëtimi për biznese (€)</i>	730,588	2,908,370	2,995,621	3,085,490
<i>D 007.3 Arkëtimi për institucione (€)</i>	436,265	90,252	92,960	95,748
<i>D 007.3 Arkëtimi nga uji me shumicë (€)</i>	0	0	0	0
D 008 Të hyrat nga kyqjet dhe të tjera	30,000	30,000	30,000	30,000
D 009 Shpenzimet operative pa amortizim	6,049,492	8,549,922	8,595,409	8,684,245
D 010 Shpenzimet jo operative (investimet vetanake)	321,502.73	399,561		
D 011 Numri i punëtorëve	360	380	400	420
I 001 Uji i pafaturuar (%)	50%	64%	63%	60%

7.2. Analiza financiare e shitjes

Analiza e të dhënave të performancës për periudhën 2025–2028 pasqyron një zhvillim të qëndrueshëm dhe të matur financiar e operacional të KRU “Mitrovica” Sh.A., duke reflektuar efektet e rritjes së tarifave, përfshirjen e komunave veriore dhe konsolidimin e sistemit të arkëtimit. Në vitin 2026, faturimi total parashihet të rritet nga 6.68 milionë € në 8.80 milionë €, duke ruajtur një trend stabil deri në 9.07 milionë € në vitin 2028, si rezultat i zgjerimit të bazës së konsumatorëve (nga 70,460 në 77,137) dhe kalimit të plotë nga faturimi me shumicë në faturim me pakicë në zonat e veriut.

Në aspektin volumetrik, uji i faturuar (m³) pritet të rritet nga 9.81 milionë m³ në 2025 në 11.30 milionë m³ në 2026 dhe në 11.76 milionë m³ në 2028, duke shënuar një rritje. Pjesën më të madhe të këtij vëllimi e përbëjnë amvisëritë (rreth 75%), ndërsa segmenti i bizneseve shënon zgjerimin më të ndjeshëm nga 1.07 milionë m³ në 2025 në mbi 2.7 milionë m³ në 2026 si rezultat i kontrollit më të mirë teknik dhe formalizimit të konsumit.

Në të ardhurat reale, arkëtimi reflekton një përmirësim të ndjeshëm të disiplinës financiare: nga 5.31 milionë € në 2025 në 9.02 milionë € në 2026, duke arritur 9.57 milionë € në 2028. Në përputhje me planifikimin, arkëtimi për njësitë jugore është parashikuar të arrijë në 105% të faturimit (duke përfshirë borxhet e vjetra), ndërsa për njësitë veriore është planifikuar një nivel realist prej 80–85%, duke reflektuar integrimin e ri të konsumatorëve dhe ndërtimin e kulturës së

pagesës.

Nga ana e kostove, shpenzimet operative rriten gradualisht nga 6.05 milionë € në 2025 në 8.65 milionë € në 2026, dhe në 8.68 milionë € në 2028, të udhëhequra kryesisht nga pagat dhe energjia elektrike, që mbeten komponentët dominantë të strukturës së kostos. Në aspektin teknik, uji i pafaturuar pritet të shënojë një rritje të përkohshme gjatë periudhës së tranzicionit (nga 50% në 2025 në 64% në 2026), për shkak të integritetit të rrjeteve të reja në veri, por të ulet gradualisht në 60% në 2028 përmes programeve të modernizimit të rrjetit, instalimit të ujëmatësve inteligjentë dhe monitorimit përmes sistemit SCADA.

Tabela 11. Plani i faturimit të ujit në m3

REKAPITULIMI KRUM - Plani i Faturimit ne m3 2026				
Kategoria	Amvisëri	Jo amviseri	Ndërkombtar	TOTAL
Janar	611,602	193,000	10,900	815,502
Shkurt	600,959	190,356	10,900	802,215
Mars	575,861	181,714	10,900	768,476
Prill	624,483	195,191	10,900	830,575
Maj	648,757	203,516	10,900	863,173
Qershor	640,717	200,780	10,900	852,396
Korrik	821,017	251,710	10,900	1,083,627
Gusht	894,843	275,452	10,900	1,181,194
Shtator	855,743	262,905	10,900	1,129,548
Tetor	783,431	239,700	10,900	1,034,031
Nëntor	787,789	241,252	10,900	1,039,941
Dhjetor	680,502	206,928	10,900	898,330
Total	8,525,704	2,642,504	130,800	11,299,008

Tabela 12. Plani i faturimit në euro

REKAPITULIMI KRUM- Plani i Faturimi në Euro për 2026				
Kategoria	Amvisëri	Jo amviseri	Ndërkombtar	TOTAL
Janar	422,005	206,510	7,521	636,036
Shkurt	414,662	203,681	7,521	625,864
Mars	397,344	194,434	7,521	599,300
Prill	430,893	208,855	7,521	647,269
Maj	447,642	217,762	7,521	672,925
Qershor	442,094	214,834	7,521	664,450
Korrik	566,502	269,330	7,521	843,352

Gusht	617,441	294,733	7,521	919,696
Shtator	590,463	281,308	7,521	879,292
Tetor	540,567	256,479	7,521	804,567
Nëntor	543,575	258,139	7,521	809,235
Dhjetor	469,546	221,413	7,521	698,481
Total	5,882,736	2,827,479	90,252	8,800,467

Tabela 13. Plani i inkasimit në euro

REKAPITULIM KRUM - Plani I Inkasimit sipas muajve dhe kategorive 2026				
Kategoria	Amvisëri	Jo amviseri	Ndërkombtar	TOTAL
Janar	443,106	216,835	7,521	667,462
Shkurt	435,395	213,865	7,521	656,781
Mars	417,212	204,156	7,521	628,889
Prill	447,211	217,271	7,521	672,002
Maj	464,352	226,451	7,521	698,324
Qershor	458,738	223,459	7,521	689,718
Korrik	571,225	273,646	7,521	852,392
Gusht	623,327	299,783	7,521	930,632
Shtator	594,010	285,303	7,521	886,834
Tetor	544,433	260,324	7,521	812,277
Nëntor	549,179	262,682	7,521	819,382
Dhjetor	472,675	224,595	7,521	704,790
Total	6,020,861	2,908,370	90,252	9,019,483

7.3. Burimet e financimit

Burimet e financimit të KRU “Mitrovica” Sh.A. bazohen në një kombinim të qëndrueshëm ndërmjet të ardhurave vetanake dhe fondeve të investimeve kapitale nga donatorët ndërkombëtarë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Komunat dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Të ardhurat vetanake sigurohen kryesisht nga faturimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, i cili përbën bazën kryesore të vetëfinancimit të ndërmarrjes.

Kështu, faturimi dhe inkasimi efikas mbeten burimi themelor për mbulimin e shpenzimeve operative, mirëmbajtjen e rrjetit dhe zhvillimin e projekteve të vogla të kapitalit vetanak. Në anën tjetër, investimet kapitale madhore financohen përmes fondeve të donatorëve ndërkombëtarë si BERZH, KFË, Bashkimi Evropian (IPA) dhe institucione të tjera zhvillimore, si dhe

përmes kontributeve të Qeverisë së Kosovës përmes subvencionimit të projekteve kapitale. Këto investime janë të fokusuara në ndërtimin e Impiantit Rajonal të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe digjitalizimit të sistemeve operative.

8. PLANI I INVESTIMEVE

Gjatë periudhës 2026–2028, KRU “Mitrovica” Sh.A. do të zbatojë një program të gjerë investimesh që synon përmirësimin e infrastrukturës, modernizimin teknologjik dhe uljen e humbjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ky plan përfaqëson komponentën kryesore zhvillimore të ndërmarrjes dhe është ndërtuar në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në këtë dokument, si dhe me politikat e financimit të miratuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

8.1. Projektet kryesore kapitale

Projektet e investimeve që parashikohen të realizohen në periudhën 2026–2028 janë si më poshtë:

Tabela 14. Investimet vetanake

Përshkrimi	Vetanake	
Furnizim dhe montim NTU sonda	7,000€	
Furnizim me frekuentor VFD per elektromotor	100,000€	
Furnizim me paisje/ mjete mbrojtese /sigurise ne teren	5,000€	
Servisimi I Ozonit	10,000€	
Furnizim me Montim I Softverit per GIS	4,200 €	
Investimi në pajisje iPad. Pajisja do të përdoret nga punonjësi për të dokumentuar në mënyrë të menjëhershme dhe të saktë të gjitha aktivitetet operative.	10,000€	
Servisimi I AUMA-ve	5,000€	
Furnizim me paisje per sistemin e klor-it	20,000€	
Laboratori në ITU-Shipol- Paisja e mëtejshme e laboratorit	20,000€	
Furnizim me Eskavator	100,000€	
Furnizim me rregullator presioni, valvula ajërimi dhe pjesë fazonike	67,500€	
Elaborati Teknik për Zonat e Furnizuara nga Puset dhe Impiantet	50,000€	
Total 2026	398,700€	
	-Per vitin 2026	
Pajisje per matje Gjeodozike “GPS”- Për të tri njesitë: Mitrovica, Skenderaj, Vushtrri.	12,000 €	

Investimet ne IT per te tri njesite operative;Zhvillimi I Sistemit të pagesave offline ne pikat e arketimit;Furnizim me PC desktop dhe Laptop;Zhvillimi I moduleve në ERP dhe Billing etj.	86,000€	
Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në rrugët Hoxha dhe Kaqini & Arsim Sadiku-Klinë e mesme.	30,000€	
Rehabilitimi I rrugëve: “ Gurra”, “Shaban Igrishta”, ‘Demë Ahmeti”, “Tish Daija”, “Qazim Cimili’,Gjon Sereqi”, “Esat Mehulli”	50,000€	
Rehabilitimi I rrugëve ne disa lagje te Mitrovicës: “ Ukshin Kovaqica”, “ Ferki Aliu”	150,000€	
Valvula operuese për të tre njesitë; Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj.	45,000€	
Investimi në pajisje iPad- Për të rritur efikasitetin operacional dhe për të siguruar një proces më të saktë dhe të standardizuar të raportimit në terren, parashikohet investimi në pajisje iPad	10,000€	
Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Infrastrukturës në Objeket Administrative	36,245 €	
Rregullimi i Kulmit ne Drejtorinë e KRUM	68,760€	
Laboratori në ITU-Shipol- Paisja e mëtejshme e laboratorit me pajisje dhe inventar shtesë	20,000€	
Totali		558,005- Per vitet 2027-2028
Totali:	916,705€	2026-2028

Tabela 15. Projektet e planifikuara

PROJEKTI		FINANCUESI					Periudha e implementimit
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, BEI, ĖBIF	Te tjera	Shuma e parashikuar	
<u>1</u>	Mitrovicë- Impianti I trajtimit të ujërave të zeza Mitrovicë-Vushtrri			39,300,000€		39,300,000€	2024-2030
<u>2</u>	Mitrovice , Vushtrri, Skenderaj, Funizimi dhe instalimi i sistemeve të sigurisë në rezervuar të ujit, satcionet e pompave të Kompanisë Rajonale të Ujesjellësit Mitrovica		200,000€			200,000€	2026-2028
<u>3</u>	Mitrovicë "Ndërrimi dhe montimi i pompave në stacionet e pompimit (Tunel i Pare, Stanterg, Frasher)				125,000€ KIËER(kemi marreveshje, jemi në fazën e sigurimit të të dhënave për Kiëer)	125,000€	2026-2028
<u>4</u>	Mitrovicë - Ngritja e parkut, impianteve Energjetike Fotovoltaike (IEFV)				2,200,000€ KFË(nuk është konfirmuar ende)	2,200,000€	2026-2028
<u>5</u>	Mitrovice Skenderaj, Ndërtimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ në Suhodoll dhe Skenderaj (Depo dhe Garazha)		270,000€			270,000€	2026-2027
<u>6</u>	Ndërtimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ (Depo Garazha, rrethoja dhe mirëmbajtja e objektit të Drejtorisë së Nj.O. - Vushtrri).		130,000€			130,000€	2026-2028
	Furnizim dhe montim NTU sonda	7,000 €				7,000 €	2026
	Furnizim me frekuentor VFD për elektromotor	100,000 €				100,000 €	2026
	Furnizim me pajisje/ mjete mbrojtëse /sigurisë në terren	5,000€				5,000€	2026
	Servisimi i Ozonit	10,000€				10,000€	2026
	Furnizim me Montim i Softverit për GIS	4,200 €				4,200 €	2026
	Servisimi i AUMA-ve	5,000 €				5,000 €	2026
	Furnizim me pajisje për sistemin e klor-it	20,000 €				20,000 €	2026
	Furnizim me Eskavator	100,000€				100,000€	2026

	Furnizim me rregullator presioni, valvula ajërimi dhe pjesë fazonike	67,500€				67,500€	2026
<u>7</u>	Vushtrri-Rehabilitimi i ujësjellësit në rrugët: "Kruja", "Arsim Muzaqi" "Naip Rashica", "Fatmir Rashica", "Hamdi Gashi", "Aziz Halili"-Prapa Hotel Kalaja				180,000 €	180,000€	2026-2028
<u>8</u>	Pajisje për matje Gjeodezike "GPS"- Për të tri njesitë: Mitrovica, Skenderaj, Vushtrri.	12,000€				12,000€	2026
<u>9</u>	Rehabilitimi i rrugëve: " Gurra", "Shaban Igrishta", 'Demë Ahmeti', ""Tish Daija", "Qazim Cimi", 'Gjon Sereqi', "Esat Mehollit"	50,000€				50,000 €	2026-2028
<u>10</u>	Rehabilitimi i rrugëve në disa lagje të Mitrovicës: " Ukshin Kovaqica", " Ferki Aliu"	150,000€				150,000€	2026-2028
<u>11</u>	Valvula operuese për të tre njesitë; Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj.	45,000€				45,000€	2026-2028
<u>12</u>	Ujëmatësit Zonal për region	40,000€				40,000€	2026-2028
<u>13</u>	Skenderaj-Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për rrugët 28 Nëntori (përfshinë rrugën Ali Gashi), Ahmet Delia, Fehmi & Xhevë Lladrovci.				107,000€ E padefinuar (Mund të jetë bashkëpunim në mes KK dhe KRUM)	107,000€	2026-2027
<u>14</u>	Mitrovicë-Ndërtimi i rezervareve stacionet e pompimit dhe shtrirja e ujësjellësit për disa fshatra të Shalës.				775,000€ KK- në bashkëpunim me KRU, E pakonfirmuar	775,000€	2026-2028
<u>15</u>	Vushtrri-Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për lokacionin ish-stacionin 'Mutfaja' tutje në rrugën 'Dëshmorët e Kombit' deri në rezervuarin pasiv në fshatin Studime Nga puseta kryesore në rr.Ana Lin deri në rr.Shotë Galica				1,800,000€	1,800,000€	2026-2028
<u>16</u>	Ndërtimi i gypave të zinkuar brenda qytetit të Vushtrrisë				285,000	285,000€	2026-2028

17	Ujësjetlesi në fshatin „Beçiq dhe Dubovc“ Stacioni Pompimit dhe Trafo Mihaliq Ujësjetlesi në fshatin „Gllavotin“ Gypi furnizues në fshatin „Prelluzhë“ Stacioni Pompimit deri në Rezervarin Samadrexhë Ujësjetlesi në fshatrat:Sfaraqak, Samadrexhë, Ropic, Maxhunaj, Dumnic e Poshtme, Stanovc i Eperme dhe Gracë “ “Rezervari Samadrexhë” Ujësjetlesi nga rezervari ekzistues deri ne rezervarin e ri dhe nga rezervari deri ne Fshatin Sllatinë Ujësjetlesi në fshatrat Smerkonicë,Tërlllobuq, Sllatinë dhe Gojbul “ dhe “Rezervari Bajskë” Riparimi I Ujësjetlesi në fshatrat Arkashticë dhe Balincë Ujësjetlesi në rrugën "Bekim Berisha Abeja" Vushtrri				3,200,000€ KK-Vushtrri, ka filluar implementimi I projektit	3,200,000 €	2025-2027
18	Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjetlesit në rrugët Hoxha dhe Kaqini & Arsim Sadiku-Klinë e mesme.	30,000€				30,000€	2028
19	Investimet ne IT per te tri njesite operative;Zhvillimi I Sistemit të pagesave offline ne pikat e arketimit;Furnizim me PC desktop dhe Laptop;Zhvillimi I moduleve në ERP dhe Billing etj.	86,000€				86,000 €	2026
20	Investimi në pajisje iPad- Për të rritur efikasitetin operacional dhe për të siguruar një proces më të saktë dhe të standardizuar të raportimit në terren, parashikohet investimi në pajisje iPad. Pajisja do të përdoret nga punonjësi për të dokumentuar në mënyrë të menjëhershme dhe të saktë të gjitha aktivitetet operative, duke përfshirë: Fotografimin e pajisjeve, pjesëve të përdorura dhe ndërhyrjeve të realizuara; Regjistrimin e lokacionit gjeografik (GPS) për çdo punë të kryer, duke mundësuar gjurmueshmëri dhe transparencë maksimale;	10,000€				10,000€	2027

	Identifikimin dhe dokumentimin e pajisjeve dhe materialeve të instaluar apo të zëvendësuar; Sinkronizimin e menjëhershëm të të dhënave me bazën qendrore përmes softuerit të dedikuar, duke eliminuar raportimin manual dhe vonesat administrative.						
<u>21</u>	Dy pompa shtytëse dhe rehabilitimi i stacionit në Suhodoll për Zveçan				250,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	250,000 €	2026
<u>22</u>	Zëvendësimi i gypit furnizues DN 200 (2,500 m) Suhodoll-Zvecan				150,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	150,000 €	2026
<u>23</u>	Instalimi i 10,000 ujëmatësve në shtëpi dhe biznese				800,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	800,000 €	2026-2028
<u>24</u>	Blerja e 2 eskavatorëve				200,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	200,000 €	2026-2027
<u>25</u>	Blerja e një autobote për ujë				100,000 €	100,000 €	2026
<u>26</u>	Blerja e 3 kamionetave operative				150,000 €	150,000 €	2026-2027
<u>27</u>	Blerja e 3 veturave(pickup) operative				100,000 €	100,000 €	2026-2027
<u>28</u>	Blerja e një kamioni për pastrim të kanalizimeve				150,000 €	150,000 €	2026-2027
<u>29</u>	Përfundim i rehabilitimit të fabrikës në Leposaviq				500,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	500,000 €	2026-2027
<u>30</u>	Furnizimi me ujë për ITU-Leposaviq nga Soçanica (~6 km)				500,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	500,000 €	2026-2027
<u>31</u>	Lidhjet me gypin kryesor për Zubin Potok				500,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	500,000 €	2026-2027

32	Turbinë – Hidrocentral në fabrikën në Zubin Potok				200,000 € Fondi per Mitrovicën-Qeveria	200,000 €	2026-2027
33	Aktiviteti: Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Infrastrukturës në Objeket Administrative (Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri) Ky aktivitet parasheh realizmin e punimeve të mirëmbajtjes dhe përmirësimit në objektet administrative në Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, me fokus në lyerjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, renovimin e banjove (përfshirë ndërrimin e elementeve sanitare dhe pllakave), rregullimin e pllakave në shkallë si dhe ndërhyrje të tjera të domosdoshme për përmirësimin estetik dhe funksional të hapësirave.	36,245€				36,245 €	2026-2027
34	Rregullimi i Kulmit ne Drejtorinë e KRUM Planifikohet rregullimi i plotë i mbulimit me qëllim parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme në infrastrukturë dhe pajisje teknike, si dhe ruajtjen e kushteve optimale të punës brenda objektit.	68,760€				68,760€	2026-2028
35	Investimi ne ITU-Shipol dhe ITU Balincë: Përmirësimi i SCADA, Dozimit dhe Infrastrukturës Teknike në ITU-Shipol.Ky projekt synon automatizimin e plotë të operimit në ITU-Shipol, përmes aktivizimit të leximit automatik të të dhënave përmes SCADA, eliminimit të ndërhyrjeve manuale. Po ashtu, përfshin rregullimin e dhomave dozuese instalimin e sistemit për dozim automatik të kimikateve dhe funksionalizimin e gjeneratorit te ozonit, me qëllim rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe cilësisë në prodhimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. (1.Objekti i klorit: duhet të investohet në funksionalizimin e sistemit automatik të dozimit dhe investime në blerje të bombolave 1,000 kg, injektoreve, senzoreve detektues të gazit, gypave transmetues të				300,000€	300,000 €	2026-2028

	klorit nga kontinieri deri të injektoret, senzoret për matjen e klorit, filtrat, valvula etj. 2) Objekti të Filtrat: auma, pajisje të IT-së, shtëch-a. 3). Objekti të ozoni dhe trajtimi i llumit: servisimi e gjeneratorit të ozonit dhe kompresorit të ajrit si dhe investime në kthimin në punë të njësia e trajtimit të llumit. 4). Objekti i kemikaleve: sigurimi i pompave të reja dozuese. 5). Blerja e të gjithë senzoreve (sondave) për matjen e parametrave përmes SCADES. 6). Paisje të IT-së, makinerisë dhe elektros. Stacioni i pompave në Lushtë: sigurimi xhundave dhe kushinetave, qarqet e pompave, amortizues të gypave, pjesë elektike, IT-së dhe makinerisë.)						
36	Laboratori në ITU-Shipol- Paisja e mëtejshme e laboratorit me pajisje dhe inventar shtesë, në mënyrë që të rritet kapaciteti dhe efikasiteti i punës laboratorike, si dhe të përmirësohet siguria dhe saktësia e analizave. Investimi do të përfshijë blerjen e pajisjeve laboratorike shtesë, materialeve harxhuese dhe mobilimit ndihmës, duke kontribuar në përmbushjen më të plotë të kërkesave të standardeve të cilësisë dhe raportimit. Ky projekt do të ndihmojë në përforcimin e monitorimit të brendshëm dhe në rritjen e besueshmërisë së të dhënave analitike	20,000€			40,000€	60,000 €	2026-2027
37	Elaborati Teknik për Zonat e Furnizuara nga Puset dhe Impiantet Parashihet angazhimi i një operatori të jashtëm për përgatitjen e një elaborati	50,000€				50,000€	2026

teknik që do të përfshijë analizën e detajuar të zonave të furnizuara nga pusët dhe impiantet ekzistuese. Qëllimi i këtij elaborati është të sigurojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për aplikimin dhe marrjen e lejeve ujore për këto zona. Studimi do të përmbajë vlerësimin e kapaciteteve të furnizimit, analizën e kushteve hidroteknike dhe dokumentimin mbështetës në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet relevante, duke kontribuar në rritjen e transparencës, saktësisë dhe përputhshmërisë teknike.						
Totali:	916,705€	600,000€	39,300,000 €	10,812,000€	53,428,705€	2026-2028

8.2. Analiza e fizibilitetit dhe ndikimit

Projekti më i madh i periudhës 2026–2028 mbetet Impianti Rajonal i Trajtimt të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, me vlerë investimi prej 39.3 milion €, i bashkëfinancuar nga BERZH, KfE, EBIF dhe Qeveria e Kosovës. Ky projekt përfaqëson një ndër investimet më strategjike në sektorin e ujit në Kosovë, pasi do të sigurojë trajtim të plotë biologjik të ujërave të ndotura për rreth 200,000 banorë të rajonit, duke reduktuar ndotjen e lumenjve Sitnicë dhe Ibër, si dhe duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe shëndetin publik. Në aspektin ekonomik, projekti është plotësisht i justifikuar nga përfitimet mjedisore, sociale dhe shëndetësore që tejkalojnë kostot kapitale. Përfitimet afatgjata përfshijnë gjithashtu kursime në mirëmbajtje, përmirësim të standardeve të ujit të shkarkuar dhe përmbushje të kërkesave të BE-së për mjedis të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Projektet tjera kapitale, me vlerë të kombinuar rreth 13.7 milion €, fokusohen në modernizimin e rrjetit të ujësjellësit, rritjen e sigurisë operative dhe digjitalizimin e sistemit të menaxhimit. Këto përfshijnë instalimin e sistemeve SCADA dhe fotovoltaike, rehabilitimin e rrjeteve në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, ndërtimin e objekteve përcjellëse administrative, si dhe instalimin e 10,000 ujëmatësve të rinj. Këto investime janë të fizibilitetit të lartë, pasi gjenerojnë përfitime të menjëhershme në reduktimin e humbjeve teknike, uljen e kostove të energjisë dhe rritjen e efikasitetit operacional. Një pjesë e konsiderueshme e projekteve financohet nga donatorët ndërkombëtarë dhe fondet qeveritare, çka ul presionin mbi burimet vetanake të kompanisë dhe rrit qëndrueshmërinë e saj financiare. Në përmbledhje, të gjitha projektet e planifikuara janë të orientuara drejt rritjes së qëndrueshmërisë teknike dhe mjedisore, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe sigurimit të një infrastrukture moderne që mbështet vizionin afatgjatë të kompanisë për shërbime cilësore dhe të qëndrueshme.

8.3. Afatet dhe prioritetet kohore

Plani i investimeve kapitale për periudhën 2026–2028 është ndërtuar mbi parimin e ndikimit strategjik dhe qëndrueshmërisë financiare, duke përcaktuar qartë fazat e zbatimit sipas rëndësisë, përfitimit ekonomik dhe efektit mjedisor. Projektet me ndikim më të madh në uljen e kostove, përmirësimin e shërbimit dhe mbrojtjen e mjedisit janë vendosur në prioritetet e para të zbatimit.

Prioriteti i parë (2026–2028) përfshin projektet energjetike, të cilat kanë rëndësi thelbësore për stabilitetin financiar të kompanisë për shkak të kostove të larta të energjisë elektrike. Investimet në Impiantet Fotovoltaike (2.2 milion €) dhe turbinën hidroenergjetike në Zubin Potok (200,000 €) synojnë të ulin ndjeshëm varësinë nga furnizimi tradicional me energji, duke siguruar kursime vjetore substanciale dhe duke kontribuar në qëndrueshmërinë mjedisore. Po ashtu, modernizimi i stacioneve të pompimit dhe automatizimi i tyre do të përmirësojnë ndjeshëm efikasitetin energjetik dhe do të reduktojnë humbjet teknike. Këto investime pritet të kenë kthim të dukshëm financiar brenda periudhës 5–7 vjeçare.

Prioriteti i dytë (2024–2030) mbetet projekti madhor i Impiantit Rajonal të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, me vlerë 39.3 milion €, i financuar nga BERZH, KFË, ĒBIF dhe Qeveria e Kosovës. Projekti është në zbatim dhe do të sjellë përfitime afatgjata në cilësinë e ujit dhe mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar përputhje me direktivat e BE-së. Kjo ndërhyrje strategjike do të krijojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Prioriteti i tretë (2026–2028) përfshin modernizimin e rrjeteve dhe sigurisë teknike, përmes rehabilitimit të linjave të vjetra, instalimit të ujëmatësave inteligjentë, përmirësimit të SCADA-s në ITU Shipol dhe Balinc, si dhe krijimit të zonave DMA për monitorim të saktë të rrjedhjeve dhe presionit. Këto investime pritet të ndikojnë drejtpërdrejt në reduktimin e humbjeve të ujit dhe optimizimin e konsumit të energjisë.

Prioriteti i katërt (2026–2027) ka të bëjë me infrastrukturën mbështetëse, përfshirë ndërtimin e objekteve përcjellëse administrative, depo-ve dhe garazhave, si dhe rehabilitimin e objekteve ekzistuese. Këto investime do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit operacional dhe në përmirësimin e kushteve të punës për stafin.

Në përmblledhje, ndarja në faza e projekteve është bërë në mënyrë që në fillim të periudhës të adresohen kostot më të larta të operimit, si energjia dhe humbjet teknike, ndërsa në fazat pasuese të përqendrohet modernizimi infrastrukturor dhe digjitalizimi. Ky plan siguron që deri në fund të vitit 2028, KRU “Mitrovica” të arrijë vetëqëndrueshmëri energjetike, efikasitet të lartë operativ dhe qëndrueshmëri financiare.

9. RREZIQET DHE MENAXHIMI I TYRE

Gjatë periudhës 2026–2028, KRU “Mitrovica” do të operojë në një ambient dinamik, me sfida të ndërlidhura që burojnë nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Analiza e rreziqeve përfshin aspekte financiare, teknike, institucionale, mjedisore dhe sociale, duke u fokusuar në parandalim, përgjigje të shpejtë dhe ndërtim të qëndrueshmërisë organizative. Menaxhimi i rrezikut është integruar në të gjitha proceset strategjike të ndërmarrjes, duke përfshirë monitorim periodik, masa korrigjuese dhe raportim të vazhdueshëm në nivel menaxherial.

Rreziqet financiare

Në aspektin financiar, ndërmarrja përballët me disa rreziqe strukturore që lidhen me stabilitetin e të ardhurave, saktësinë e raportimit dhe kostot operative. Rreziku kryesor mbetet mosrealizimi i të hyrave për shkak të mospagesave nga konsumatorët, veçanërisht në komunat veriore, ku faktorët politikë dhe mungesa e kontrollit të plotë ndikojnë në arkëtimet. Po ashtu, ndryshimet në strukturën tarifore të miratuar nga ARRU, rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe inflacioni operacional mund të ndikojnë ndjeshëm në qëndrueshmërinë financiare.

Rreziqe shtesë përfshijnë:

- Raportime të pasakta financiare për shkak të mungesës së integritetit të plotë të softuerëve ekzistues;
- Vonesa në financime kapitale nga donatorët dhe projektet qeveritare;
- Varësia e lartë nga energjia elektrike që ndikon në kostot fikse mujore.

Masat parandaluese përfshijnë:

- Forcimin e kontrolleve të brendshme financiare dhe auditimit të rregullt të pasqyrave sipas IAS/IFRS;
- Zbatimin e sistemit të integruar të raportimit financiar dhe kontrollit të riskut;
- Krijimin e një fondi rezervë për mbulimin e krizave;

Rreziqet teknike dhe operative

Rrjeti i amortizuar, defektet e shpeshta dhe ndërprerjet e energjisë mbeten burime të rëndësishme rreziku për operimin e pandërprerë. Humbjet e ujit (NRË) mbi 45% janë ende të larta, duke ndikuar në eficiencën e përgjithshme. Përdorimi i teknologjive të vjetruara në disa impiante dhe mungesa e pjesëve rezervë rrit rrezikun e vonesave në riparime.

Masat parandaluese:

- Zbatimi i mirëmbajtjes preventive dhe reaktive në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Monitorimi në kohë reale përmes sistemit SCADA;

-
- Investime në pajisje moderne, gjeneratorë rezervë dhe sisteme automatike për matje.

Rreziqet mjedisore

Ndryshimet klimatike, ndotja e burimeve ujore dhe thatësiat e mundshme përbëjnë kërcënime të vazhdueshme për furnizimin me ujë të pijshëm. Rreziku mjedisor është më i theksuar në zonat rurale dhe në pikat e kapjes së ujit në Lushtë dhe Balinc, ku aktivitetet njerëzore mund të ndikojnë në cilësi. Po ashtu, ndotja nga ujërat e zeza dhe menaxhimi joefikas i mbetjeve paraqesin rrezik për mjedisin.

Masat:

- Monitorim i përhershëm i cilësisë së ujit sipas Udhëzimit Administrativ 10/2021;
- Forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe komunat për mbrojtjen e burimeve ujore;
- Zhvillimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura dhe sigurimi i certifikimeve të cilësisë.

Rreziqet në burimet njerëzore

Rritja e numrit të punonjësve nga 260 në 406 për shkak të zgjerimit të zonës operuese sjell sfida të rëndësishme menaxheriale. Mungesa e automatizimit të proceseve Bnj dhe numri i kufizuar i stafit të dedikuar (aktualisht vetëm një person) rrit rrezikun për vonesa, gabime në administrim dhe koordinim joefikas të trajnimeve. Po ashtu, daljet në pension të 24 punonjësve deri në fund të vitit 2026 dhe nevoja për 37 rekrutime të reja paraqesin presion shtesë mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

Masat:

- Zbatimi i një sistemi digjital për menaxhimin e BNJ (HRIS);
- Planifikimi i trajnimeve periodike për zhvillim profesional në të gjitha departamentet;
- Hartimi i planeve për zëvendësim dhe zhvillim të karrierës;
- Promovimi i barazisë gjinore dhe politikave për përfshirje sociale;
- Përgatitja e planeve emergjente për menaxhimin e mungesave në pozita kritike.

Përmbledhje

Në përfundim, KRU “Mitrovica” do të zbatojë një Sistem të Integruar të Menaxhimit të Rrezikut që përfshin identifikimin, analizën dhe reagimin e koordinuar ndaj çdo rreziku financiar, teknik, mjedisor dhe institucional. Ky sistem do të mbikëqyrret nga një strukturë e dedikuar pranë zyrës Ekzekutive, me raportim të rregullt tremujor për Bordin e Drejtorëve dhe institucionet rregullatore. Qasja e ndërmarrjes është parandaluese dhe proaktive, duke siguruar stabilitetin financiar, qëndrueshmërinë operative dhe transparencën në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e rajonit të Mitrovicës.

10. PJESA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

KRU "Mitrovica" Sh.A. vepron si shoqëri tregtare, me aksionet në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Organizimi operativ dhe financiar i saj ndjek dispozitat ligjore të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, përfshirë:

Ligjin nr. 06/L 016 për Shoqëritë Tregtare;

Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03/L 087 dhe amendamentet përkatëse (Ligjet nr. 04/L 111 dhe 05/L 009);

Ligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit nr. 05/L 042;

Ligjin nr. 05/L 063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L 048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;

Ligjin për ujërat nr. 04/L 147;

Ligjin e Punës nr. 03/L 212;

Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 06/L 082;

Ligjin mbi Festat Zyrtare nr. 03/L 064.

11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Biznesit përbën një proces të vazhdueshëm që synon të sigurojë se objektivat strategjike po realizohen në përputhje me afatet kohore dhe burimet e parashikuara.

KRU “Mitrovica” do të zbatojë një mekanizëm të integruar të raportimit, që përfshin mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave për performancën financiare dhe teknike.

11.1. Mekanizmat e monitorimit

- Raportime mujore dhe tremujore për progresin e aktiviteteve;
- Rishikim i planit të biznesit çdo vit në përputhje me ndryshimet ekonomike e rregullatore;
- Vlerësim i IKP-ve kryesore: prodhimi, faturimi, arkëtimet, humbjet, kostot operative dhe investimet.

11.2. Indikatorët e performancës

Disa nga IKP-të kryesore që do të monitorohen janë:

- Mbulueshmëria me ujë të pijshëm (% e popullsisë së licencuar);
- Uji i pafaturuar (% e prodhimit);
- Niveli i arkëtimeve (% e faturimit);
- Raporti i mbulimit të kostove (CCR);
- Cilësia e ujit sipas standardeve të analizave laboratorike.

Rezultatet do të raportohen rregullisht tek Bordi i Drejtorëve dhe ARRU, ndërsa gjetjet do të përdoren për përmirësime të brendshme dhe përditësim të planit në bazë të zhvillimeve të reja.

12. MJEDISI, KOMUNITETI DHE TRANSPARENCA

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale, mjedisi, komuniteti dhe transparenca përbëjnë shtyllat themelore të politikave korporative të KRU “Mitrovica” Sh.A. Këto fusha janë të ndërlidhura ngushtë me strategjinë e marketingut institucional, e cila synon jo vetëm promovimin e shërbimeve dhe arritjeve të ndërmarrjes, por edhe forcimin e besimit publik dhe ndërgjegjësimit qytetar për përdorim të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Përmes aktiviteteve të marketingut, ndërmarrja synon të forcojë komunikimin me komunitetin lokal, të promovojë vlerat e mbrojtjes së mjedisit dhe të nxisë pjesëmarrjen qytetare në ruajtjen e ujit si pasuri publike. Kjo strategji përfshin organizimin e ngjarjeve publike me karakter edukativ e sensibilizues, me theks të veçantë në shënimin e “Ditës Botërore të Ujit” më 22 mars, ku përfshihen institucionet arsimore, organizatat lokale dhe qytetarët e rajonit të Mitrovicës. Këto aktivitete shërbejnë si platformë për ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet ndërmarrjes dhe komunitetit, duke rritur transparencën dhe imazhin pozitiv të KRU “Mitrovica” si ofrues i besueshëm i shërbimeve publike.

Gjithashtu, është planifikuar realizimi i një dokumentari televiziv promovues, që do të paraqesë në mënyrë vizuale ciklin e plotë të menaxhimit të ujit – nga kaptimi në burim, trajtimi dhe shpërndarja, deri te përdorimi nga konsumatorët. Ky material do të shërbejë si mjet komunikimi dhe transparence për të informuar qytetarët mbi investimet, sfidat dhe arritjet e kompanisë, duke theksuar përkushtimin ndaj cilësisë, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Nëpërmjet këtij kombinimi të marketingut strategjik, transparencës institucionale dhe angazhimit komunitar, KRU “Mitrovica” synon të ndërtojë një kulturë bashkëpunimi dhe përgjegjësie të përbashkët, ku qytetarët janë jo vetëm konsumatorë, por edhe partnerë në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

SHTOJCË

Tabela 16. Burimet ujore

Nr	Emri i burimit	x	y	z	Komuna	Kapaciteti (l/s)	Lloji i burimit
1	Liçeni i Ujëmanit	7470571.489	4755158.735	689	Zubin Potok	13,500	Akumulues




Figura 4. Burimet ujore